

BISMIL'LAHI'R-RAHMANI'R-RAHIM

**AHLAKU I MUHAMMEDIT
S.A.V.S.**

Imam Gazali

Prishtinë 2017

Ihjau Ulumid-din
(Ringjallja e diturive fetare)

Kitâbu âdâbi'l- maishet ve ahlâki'n-nubuvvet
Imam Gazali

Përgatiti dhe përktheu
Shenaj Zeneli

Lektor:
Artan Sadiku

Përgatitja kompjuterike:
Abdullah B. Ferizi

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	5
EDUKATA E ALLAHUT TEALA DHËNË ME KUR'AN TË DASHURIT TË TIJ, MUHAMMEDIT S.A.V.S.	9
KËSHILLAT E RESULALLAHUT S.A.V.S.....	17
PJESË TË AHLAKUT TË BUKUR TË RESULALLAHUT S.A.V.S., NGA PËRMBLEDHJET E DISA DIJETARËVE	19
NJË PJESË TJETËR NGA MIRËSJELLJA DHE AHLAKU I RESULALLAHUT S.A.V.S.	25
FJALIMI DHE BUZËQESHJA E TIJ.....	31
EDEBI DHE AHLAKU I RESULALLAHUT S.A.V.S. NË TË USHQYER	35
MIRËSJELLJA (EDEBI) DHE AHLAKU I RESULALLAHUT S.A.V.S., NË VESHJE	43

FALJA E RESULTALLAHUT S.A.V.S., ANI PSE KISHTE FUQI PËR HAKMARRJE.....	49
SI RESULTALLAHU S.A.V.S., E MBYLLI SYRIN NGA AJO QË NUK E PËLQENTE	55
XHYMERTLLËKU (BUJARIA) E RESULTALLAHUT S.A.V.S.....	58
MODESTIA E RESULTALLAHUT S.A.V.S.	63
PAMJA DHE QËNDRIMI I RESULTALLAHUT S.A.V.S.	67
MUXHIZET DHE SHENJAT QË E DËSHMOJNË VËRTETËSINË E RESULTALLAHUT S.A.V.S.	72

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit!

PARATHËNIE

Falënderimi (hamd) i takon vetëm Allahut. Ai Allah që krijoi çdo gjë në formën më të bukur dhe e zbukuroi atë që krijoi, dhe në mënyrën më të bukur e edukoi të Dërguarin, Muhammedin s.a.v.s.. Ia pastroi ahlakun¹ e cilësitë dhe e mori nën mbrojtje dhe për mik. Atyre që u dëshiroi hidajet² në ezel³ iu siguroi dhe sukses që të pasojnë rrugën e tij, ndërsa atyre që u dëshiroi humbje i largoi nga stolisja me ahlakun e tij.

Salat dhe selam zotërisë të pejgamberëve, Muhammedit (s.a.v.s.) dhe ehli-bejtit, as'habëve të tij të ndershëm dhe të pastër.

¹ **Ahlak (sh. Hulk):** moral; shprehje; veçori; natyrë; karakter; sjellja dhe qëndrimi moral i njeriut

² **Hidajet:** udhëzim; orientim; drejtësi; rrugë e drejtë; rrugë e vërtetë; ta shohësh të vërtetën të vërtetë dhe të kotën të kotë dhe të hysh në rrugë të drejtë; Islam

³ **Ezel:** gjithë egzistimi; i pari (evel) që nuk ka fillim; gjithmonë që egziston; pa fillim.

Pas kësaj dije se: edebet⁴ e jashtme (*zahir*) janë shenjë e edebeve të brendshme (*batin*). Lëvizjet e gjymtyrëve trupore janë fryte të dëshirave. Ndërsa veprimet janë përfundime të ahlakut. Mirësjellja dhe edukimi lind nga marifeti. Zemra, që në vete e fsheh dashurinë, është burim i veprimeve dhe vend i shfaqjes. Shkëlqimi në të jashtmen, është drita (*nuri*) që lind në zemër. Ky nur e zbukuron të jashtmen dhe shndrit. Gjendjet e shëmtuara dhe të këqija zëvendësohen me gjendje të mira. Zemra e atij që nuk është penduar, as gjymtyrët tij nuk do të jenë penduar. Zemra e atij që nuk është ngrohur me nurin hyjnor, as në veprime nuk do t'i shfaqen bukuritë e edebeve të Pejgamberit.

Kam menduar të përfundoj çerekun e këtij vëllimi me një libër i cili do të përmbledhte edebet mbi mënyrën e jetesës, ashtu që lexuesi pas kësaj të mos e ketë të vështirë të nxjerrë të dhëna nga libra të shumtë. Më pas kam parë që në çdo libër jenë treguar shumë gjëra rreth edebit, andaj

⁴ **Adab (sh. Edeb):** edukim; ahlak i bukur; urtësi; i ndrojtur/i marrshëm; metodë; rrugë; sellje; mirësjellje; rregullat e sjelljes.

përsëritja e tyre nuk është e nevojshme; sepse përsëritja vështirëson, dhe zemrat nuk kënaqen nga gjëra të tilla. Andaj vendosa të tregoj në këtë libër vetëm edebet dhe ahlakun e dokumentuar (të qartë) të të Dërguarit të Allahut, s.a.v.s., dhe në saje të kësaj të gjitha edebet së bashku, me iman të rigjallërohen. Kështu lind njohja e ahlakut të tij. Kjo dëshmon kategorikisht se ai ka qenë krijimi më fisnik i Allahut, robi i gradës më të lartë dhe vlerës më të madhe, e si të pritet që në këtë kohë të shihet komplet ahlaku?

Kur flasim për ahlakun e tij, do të përmend qëndrimin dhe pamjen e tij të jashtme, *muxhizet*⁵ që janë vërtetuar me transmetime të drejta, që në saje të kësaj të kuptohet më mirë natyra dhe ahlaku, vlera e lartë e tij dhe për t'ia mbyllur gojën atyre që e mohojnë pejgamberllëkun e tij.

⁵ Mrekulli (më lartë se kerameti), të cilën njerëzit nuk kanë mundësi ta bëjnë përveq pejgamberëve të cilëve Allahu Teala ju ka mundësuar; një vërtetim prej anës së Krijuesit të gjithësisë për Pejgamberët e tij; paraqitje e mrekullisë apo e gjendjeve të jashtëzakonshme të Pejgamberëve (alejhimusselam) me lejën e Allahut Teala si dëshmi për pejgamberllëkun e tyre. Për muxhizet është lajmëruar dhe konstatuar në hadithet sahih.

Allahu Teala ndihmon në përputhjen e ahlakut dhe gjendjeve të tjera Muhammedit s.a.v.s.. Allahu Teala udhëzon të humburit dhe pranon lutjet e nevojtarëve.

Së pari do të tregojmë se si Allahu Teala e edukoi Muhammedin s.a.v.s. me Kur'anin Kerim, më pas do të flasim për ahlakun e tij të pashoq, për këshillat e tij, më pas do të përmendim disa nga edebet e tij dhe moralin e tij të mirë, mënyrën e të folurit dhe buzëqeshjen e tij, më pas virtytet e tij dhe edebet në të ushqyer, virtytet dhe edebet tek veshja, më pas do të flasim për faljen (rahmetin) e tij, ani pse kishte fuqi për hakmarrje, pastaj si e mbyllte syrin nga ajo që nuk e pëlqente, më pas xhymertllëku (bujaria) e tij, trimëria e tij, modestia e tij, pamja dhe qëndrimi i tij, pastaj muxhizet dhe shenjat që dëshmojnë vërtetësinë e tij, paqja dhe bekimi qoftë mbi të.

EDUKATA E ALLAHUT TEALA DHËNË ME KUR'AN TË DASHURIT TË TIJ, MUHAMMEDIT S.A.V.S.

Resulallahu s.a.v.s., gjithmonë kërkon nga Allahu Teala të zbukurohet me ahlak dhe edukim të mirë dhe në duá do të thoshte:

“Allahu im zbukuroje pamjen dhe ahlakun tim.”⁶

Ai thoshte edhe:

“Allahu im largoi nga unë veset e këqija.”⁷

Edhe Allahu Teala dha premtimin hyjnor:

“Lutmuni Mua, se do t’ju përgjigjem!”

40- Gafir: 60

Me premtimin hyjnor dhe duke iu përgjigjur lutjes së tij, ia zbriti Kur’anin dhe me atë e edukoi, ashtu që ahlaku i tij ishte përbërë plotësisht nga Kur’ani Kerim.

⁶ Ibn Mesudi nga Aisha r.a., ekzistojnë edhe rrugët dhe transmetime tjera.

⁷ Tirmidhiu nga Kutbe b. Maliku; Hakim ka thënë se është i besueshëm, sahih.

Sa'd ibn Hisham rrëfen:

Hyra tek Ajsha r. anha, e pyeta për ahlakun e Muhammedit, s.a.v.s., e ajo më tha:

“A po mëson Kur’an?”, “Natyrisht”, i thashë, e pastaj ajo tha:

“Ahlaku i Resulallahut s.a.v.s., ishte Kur’ani. Kur’ani Kerim atë e ka edukuar me këto ajete dhe të tjera të ngjashme:

“Trego mëshirë, urdhëro vepra të mira dhe shmangu nga të paditurit.” 7-A’raf: 199

“Në të vërtetë, Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën për të afërmit, si dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën.” 16- Nahl: 90

“...bëhu i durueshëm për çfarëdo që të godet! Me të vërtetë, ky është thelbi i patundur i të gjitha punëve!” 31-Lukman: 17

“Kushdo që duron dhe fal, ta dijë se, në të vërtetë, këto janë nga veprimet më të virtytshme.” 42-Shura: 43

“Pra falju dhe hiq tyre. Allahu i do ata që bëjnë mirë.” 5-Maide: 13

“Le t’i falin ata dhe të mos ua marrin për keq! Vallë, a nuk doni ju që t’ju falë Allahu?” 24-Nur: 22

“Andaj, (të keqen) ktheje në mënyrën më të mirë, se atëherë ai, me të cilin kishit njëfarë armiqësie, do të bëhet mik i afërt.”

41-Fussilet: 34

“...e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit.”

3-Al-Imran: 134

“Mënjanoni shumë dyshime, se, vërtet, disa dyshime janë gjynah. Mos e spiunoni dhe mos e përgojoni njëri-tjetrin!”

49- Huxhurat: 12

Kur në betejën e Uhud-it Resulallahut s.a.v.s., i ishte çarë faqeja dhe thyer dhëmbi, deri sa po i rridhte gjaku nëpër fytyrë, me një dorë e fshinte gjakun dhe thoshte:

“Si do të arrin shpëtimin populli që gjakosin fytyrën e të Dërguarit të Allahut, derisa ai i thërret ata në shpëtim?”⁸

⁸ Muslimi nga Enesi, ndërsa si pezull (*muallak*) e transmeton edhe Buhariu.

Allahu Teala e shpalli ajetin:

Ti nuk ke asgjë në dorë. (3-Al’Imran: 128) si masë edukative. Në Kur’an ekzistojnë shumë ajete edukative ngjashëm kësaj. Pikërisht Resulallahu s.a.v.s., është i pari përmes së cilit bëhet edukimi dhe zbatimi i ahlakut. E më pas, ky nur, prej tij përhapet tek njerëzit e tjerë. Ai ishte edukuar me Kur’an dhe të tjerët i edukoi më atë. Për këtë Resulallahu s.a.v.s., tha:

“Jam dërguar që të plotësojë bukuritë e ahlakut.”⁹

Për këtë kemi folur në librin *‘Shërimi i zemrës, zbukurimi i ahlakut dhe edukimi i nefsit’*, andaj të mos përsëritemi.

Pasi Allahu Teala e ngriti në shkallën e përsosur ahlakun e Resulallahut s.a.v.s., duke e lavdëruar atë, tha:

“Vërtet, ti je në një shkallë të lartë të ahlakut.” 68-Kalem: 4

⁹ Ahmedi, Bejhakui dhe Hakimi nga Ebu Hurejre r.a.

Sa i lavdishëm është Ai Allah i madh! Shiko vetëm mirësinë e Tij të pafund dhe dashamirësinë e madhe, Vet e zbukuroi me ahlak të bukur Resulallahun s.a.v.s., dhe këtë virtyt ia përvetësoi atij duke thënë:

“Ti je në një shkallë të lartë të ahlakut.”

E më pas Resulallahu, s.a.v.s., u tha njerëzve:

“Allahu Teala e do ahlakun e bukur (virtytet) dhe urren gjendjet të këqija.”¹⁰

Hazreti Alia r.a., ka thënë:

“Sa e çuditshme është me muslimanin tek i cili vjen vëllau i tij me një kërkesë të caktuar, e ai nuk i ndihmon duke pasur mundësi. Edhe nëse nuk frikësohet për sevap dhe gjynah, në emër të njerëzimit dhe ahlakut të bukur është dashur të ndihmojë, sepse kjo është rruga e shpëtimit.”

Në këtë, një person e pyet:

“A e ke dëgjuar ti këtë nga Resulallahu s.a.v.s.?”, në çka Alia r.a., tha:

“Po, e dëgjova. Ai në këtë çështje kishte qëndrim më të hairit. Bile, kur Resulullahut

¹⁰ Bejhaki nga Sehl ibn Sa'da.

a.s., i sollën robë lufte nga fisi Tajj, nga mesi i tyre një vajzë tha:

- O Muhammed, unë jam Sufan, e bija e Hātim-i Tāi, kryetarit të fisit Tajj. Babai im e do drejtësinë, tregohet i sjellshëm me ata që udhëheq, ai i liron robët e luftës, ushqen të uriturit, shpërndan ushqim, përshëndet, atë që vjen në nevojë nuk ia ka kthyer duar zbrazët, është i xhymertë dhe bujar. Nese nuk dëshiron që unë të poshtërohem, atëherë më lironi të shkoj. Resulallahu s.a.v.s., tha:

- Oj skllave, këtë që e tregove - me të vërtetë është cilësi e besimtarit. Po të ishte musliman babai yt, do të luteshim për të me mëshirë (rahmet). Lirojeni këtë vajzë, sepse babai i saj e do ahlakun e bukur, e edhe Allahu Teala e do ahlakun e bukur.

Në atë u ngrit Ebu Burde Ibn Nijar dhe tha:

- O i Dërguari i Allahut, a e do Allahu ahlakun e bukur? Resulallahu s.a.v.s., tha:

- Pasha Atë në dorën e të cilit është shpirti im, në Xhennet nuk do të hyjnë, përveq atyre me ahlak të bukur.”¹¹

¹¹Tirmidhiu dhe Hakimi transmetojnë në *‘Nevadiru’l-Usul’*

Nga Muadh b. Xhebel r.a.,
transmetohet se Resulallahu s.a.v.s., thoshte:

**“Allahu Teala Islamin e pajisi me ahlak
dhe vepra të bukura.”**

Këtu përfshihen shoqërimi i këndshëm me të tjerët, veprat fisnike, komunikimi i këndshëm dhe i hareshëm, vepra të bamirësisë, ndarja e ushqimit me të tjerët, dhënia e selamit qoftë edhe njeriu i keq, vizita tek muslimani i sëmuar, shkuarja ne xhenaze të vëllaut musliman, marrëdhënie të mira fqinjësore - qoftë me musliman apo pabesimtarë, respekt ndaj muslimanëve të moshuar, përgjigje ndaj ftesës për në gosti, falje, ndërmjetësim për të pajtuar njerëz, bujari, tolerancë, të jetë i pari në dhënien e selamit, mposhtja e zemërimit, falja e gabimeve të njerëzve, largimi nga ajo që islami e ndalon siç është përtacia, bixhozi, lojërat, të kënduarit dhe ngjashëm, thashethemet, gënjeshttrat, koprracia, lakmia, mizoria, dinakëria, mashtrimi, shpifjet, marrëdhëniet jo të mira njerëzore, ndërprerja e lidhjeve farefisnore, ahlaku i keq, mendjemadhësia, vetë-lavdërimi, vetë-

pëlqimi, poshtërimi i njeriut, fyerja me fjalë, përdorimi i fjalëve të pamoralshme, kërkimi i mangësive tek tjetri, urrejtja, xhelozia, interpretimi i keq, egërsia, paragjykimi, dhuna, armiqësia dhe padrejtësia.

Largimi prej gjendjeve të tilla është nga ahlaku i bukur. Enesi, r.a., tregon:

- Resulallauhu s.a.v.s., na thërret dhe na urdhëron për të bërë çdo mirësi, e na ndalon dhe frikëson nga çdo lloj veprimi të keq.

Kuptimin e gjithë kësaj që u përmend më lartë, ky ajet e përfshin në një vend:

“Në të vërtetë, Allahu urdhëron drejtësinë dhe mirësinë.” 16-Nahl: 90

KËSHILLAT E RESULALLAHUT S.A.V.S.

Muadhi rrëfen: *“I Dërguari a.s. më tha:*

- O Muadh! Të këshilloj të frikësohesh prej Allahut, të flasësh të vërtetën, të mbashë premtimet, të meritosh besimin, të mos tradhëtosh, të mbrosh komshiun, të tregosh mëshirë ndaj jetimit, të flasësh butë, t’i japësh salam çdokujt dhe të jesh modest, të jesh në punë të mira, të mos jesh pesimist, t’a ruash besimin (iman), ta kuptosh Kur’anin, dashurinë ndaj Xhennetit, frikë nga dhënia e llogarisë dhe shtrirje e dorës ndaj çdokujt me dashamirësi.

Ndërsa të ndaloj të flasësh fjalë të këqija ndaj të mençurit, që ta gënjesh të vërtetën, t’i përshtatesh gjynahqarit, të bëhesh kryengritës ndaj udhëheqësit të drejtë, dhe nxitjen e përçarjen.

Të këshilloj: në çdo vend të jesh me devotshmëri dhe menjëherë të bësh teube - nëse ke bërë gjynah fshehurazi, atëherë bëj edhe teube fshehtas, e nëse bën gjynah haptazi, atëherë haptazi bëj teube.”¹²

¹²Ebu Naim në *‘Hilje’* dhe Bejhakiu në *‘Shuabu’l-Iman’*

Ja kështu Resulallahu a.s., fton në edukatë dhe ahlak të bukur, kështu i ka lartësuar robët e Allahut, me fisnikëri dhe me fjalë të mira.

**PJESË TË AHLAKUT TË BUKUR TË
RESULALLAHUT S.A.V.S., NGA
PËRMBLEDHJET E DISA DIJETARËVE**

Resulallahu s.a.v.s., ka qenë njeriu më i butë, më trimi, më i drejti, më i ndershmi dhe më i virttyshmi. Dora e tij nuk ka prekur asnjëherë dorën e një gruaje që nuk ka qenë nën kurorën tij, apo e afërt e me të cilën nuk mund të martohet. Ishte pikërisht Resulallahu, a.s., njeriu më bujar, asnjë dinar (monedhë ari), apo dërhëm (monedhë argjendi), nuk ka kaluar tek ai natën. Sikur diç t'i mbetej e mos të gjindej dikush me të cilin do t'a ndante, dhe nata të vije befas, nuk do të kthehej në shtëpi derisa t'a ndante me njerëzit që kishin nevojë për to. Nga ushqimi me të cilin Allahu e furnizonte nuk do të merrte më shumë se aq sa t'i mjaftonte për një vit, dhe atë nga elbi dhe hurmeja më e thjeshtë. Të gjitha të tjerat do ti dhuronte për rizanë e Allahut. Jepte çdo gjë që kërkohet prej tij e që e kishte, aq sa ndonjëherë edhe mbetej keq për gjërat e nevojshme për jetë, për vete dhe familjen, ndonjëherë derisa

kalonte viti, asgjë tjetër nuk i vinte përsa i përket ushqimit.

Ai riparonte sandalet, qepte rrobat, ndihmonte familjarët në punët e tyre dhe në kuzhinë, copëtonte mishin bashkë me ta.

Ka qenë njeriu më i turpshëm nga të gjithë. Askënd nuk e ka shikuar drejtë në fytyrë. Është përgjigjur edhe në thirrjen e skllavit dhe të njeriut të lirë. Ka pranuar dhuratë, edhe nëse ajo ka qenë vetëm një gëllënjë qumësht, apo paçe (mish me edh). Ai do ta shpërblente me diçka, dhe do ta hante si dhuratë. Por, sadakanë nuk e hante. Pa druajtje pranonte ftesën e skllavëve dhe të varfërve. Vetëm për Allahun nevikosej e kurrë për veten. I ka mbetur besnik të vërtetës, edhe po qe ajo në dëmin e tij, apo në dëm të as'habëve të tij.

Njëherë i është ofruar ndihmë nga një myshrik (politesit) por ai nuk pranoi duke thënë: **“Nuk ndihmohem nga myshrikët.”**

Një hebrejnë u gjet i mbytur në mesin e as'habëve. Kundër tyre gjykoi dhe nuk u nda nga drejtësia. Edhe pse as'habët kishin nevojë edhe për një deve, ai gjykoi me njëqind deve pagesë për gjak.

Ka ndodhur që ka lidhur gur mbi bark për shkak të urisë. Ushqehej me atë që kishte. Nuk refuzonte atë çfarë kishte për të ngrënë, dhe asnjëherë nuk largohej nga ushqimi që ishte hallall. Nëse në vend të bukës kishte hurma, ai do t'i hante ato hurma. Nëse kishte mish të pjekur, atë do e hante. Nëse do të ndeshesh në diçka të ëmbël apo mjaltë, ai poashtu do t'a hante. Nëse do të kishte qumësht në mungesë të bukës, ai do të kënaqej me qumësht. Nëse do të kishte shalqi, pjepër apo zarzavate dhe pemë të freskëta, ai do t'i hante ato. Nuk hante mbështetur, as në tavolinë.

Duke preferuar të tjerët deri në vdekje, për tri ditë rresht nuk ishte ngopur me bukë gruri. Kjo nuk ishte nga varfëria ose koprracia.

I është përgjigjur ftesës për në ahengun martesor, i vizitoi të sëmurit dhe mori pjesë në varrime, në mesin e armiqëve

shkonte vetëm dhe pa roje. Ishte njeriu më modest, nuk është gjindur gjurmë nga mendjemadhësia te ai. Fliste kuptime më të gjera dhe më të thella, por duke mos e zgjatur. Ishte njeriu më fytyrë të buzëqeshur. Asgjë që ishte pjesë e kësaj bote nuk e tërhiqte atë. Është veshur me ato roba që gjendeshin atypari, nganjëherë roba të vjetra, nganjëherë xhybe e Jemenit dhe nganjëherë xhybe e leshtë. Ajo çfarë ishte mubah ai atë do vishte.

Unazën e kishte nga argjendi. E mbante në gishtin e vogël në dorën e djathtë, nganjëherë edhe në dorën e majtë. E merrte shërbyesin apo ndonjë tjetër në pjesën e pasme të shalës së kalit. Do të kalëronte atë kafshë e cila gjindej atypari, nganjëherë kalin, devën, mushkën, nganjëherë gomarin, e nganjëherë shkonte edhe këmbëzbathur pa xhybe, pa çallmë dhe pa kapelë.

I vizitonte të sëmurit në pjesët më të largëta të Medinës. I pëlqenin aromat e mira, dhe i kundërshtonte aromat e pakëndshme. Shoqërohej me fukara dhe hante me ta. I nderonte ata që bënin mirë në vendin e tyre,

derisa me dashamirësi i mbante lidhjet me ata që kishin ndikim. Interesohej për akrabatë dhe i preferonte më të ndershmit.

Askujt nuk i ka bërë padrejtësi, dhe pranonte ndjesë nga ata që kërkojnë falje.

Bënte shaka, por vetëm të vërtetën e thoshte. Qeshte, por jo me zë.

I shikonte lojërat të cilat ishin mubah dhe ato nuk i refuzonte. Garonte me bashkëshorten.

Ngrisinin nganjëherë zërin ndaj tij, por ai duronte.

I kishte disa deve dhe dele të cilat mjeleshin me të cilin qumësht i ushqente familjen dhe vehten. I kishte disa shërbëtore (skllave) dhe shërbëtor (skllav), por nuk ndahej nga ta, qoftë në ushqim apo në veshje.

Nuk i kalonte asnjë moment nga koha në punë e që nuk ishte për Allahun Teala. Ishte i zënë ose me ibadet ose me diçka që ishte e nevojshme. Dilte në vreshtë dhe kopshtet e as'habëve të tij. Nuk e

nënvlerësonte fukaranë për shkak të varfërisë së tyre, as nuk e vlerësonte të pasurin për shkak të pasurisë së tyre. Secilin e ftonte tek Allahu në kushte të barabarta.

Allahu Teala kishte mbledhur tek ai gjithë ahlakun dhe cilësitë e bukura në mënyrë të përsosur për udhëzimin në rrugë të drejtë.

Ai ishte i paarsimuar: as nuk lexonte as nuk shkruante. U rrit në vendet e paditurisë dhe shkretëtirës, në varfëri, duke ruajtur delet, jetim - pa baba dhe pa nënë.

Allahu Teala ia mësoi të gjitha vlerat e larta të ahlakut dhe e bëri posedues me cilësitë më të mira, ia shpalosi njohuritë nga e kaluara dhe e ardhmja, ia tregoi rrugët e lumturisë dhe shpëtimit në ahiret, ia tregoi rrugën e dashurisë së ahiretit, ia tregoi nevojën e zbatimit të detyrimeve (*vaxhib*) duke braktisur gjërat boshe. Allahu Teala na ndihmoftë në përshtatje në veprat e tij, amin ja Rabb-el-alemin!

NJË PJESË TJETËR NGA MIRËSJELJA DHE AHLAKU I RESULALLAHUT S.A.V.S.

Sipas transmetimit të Ebu'l-Buhturit, Resulallahu s.a.v.s., nuk ka qortuar askënd nga muslimanët. Nëse ndodh që me fjalë të lëndojë ndonjë person, menjëherë ia heqte mërzinë. Poashtu nuk mallkoi, nuk e mallkoi asnjë grua, dhe asnjë shërbëtor. Në një luftë kërkonin nga ai që të mallkojë, e ai në këtë tha:

“Unë jam dërguar si mëshirues. Nuk jam dërguar si mallkues!”¹³

Kur kërkonin nga ai që të mallkojë muslimanin apo pabesimtarin, qoftë bashkë apo veçantë, ai bënte dua.

Asnjëherë me dorën e tij nuk ka goditur askënd, përveç për rizanë e Allahut. Përveç drejtësisë së Allahut, kurrë nuk është hakmarrë në emër të vet. Kur i është ofruar që të zgjedh në mes dy gjërave ai e zgjidhte atë që ishte më e padëmshme, vetëm nëse aty nuk do të ishte përfshirë ndonjë haram

¹³ Muslimi nga Ebu-Hurejre r.a.

apo shkëputje e lidhjeve familjare, atëherë nuk do të afrohej aty.

Kur kërkonin nga ai, qoftë skllave, apo skllav, qoftë i pasur apo fukara, çdokujt i plotësonte nevojat e tyre. Enesi r.a., skllavi i lirë (ish-skllav) i Resulallahut s.a.v.s., nën betim tregon:

- *Kur kam bërë një punë që nuk i ka pëlqyer, kurrë nuk më ka thënë:*

- ***Pse e bëre këtë kështu?***

E kur gratë e tij tentonin të më qortojnë, i parandalonte dhe thoshte:

- ***Lëreni! Puna e tij është në pajtim me libër dhe kader.***

Nuk ka kritikuar asnjë lloj shtrati në të cilin shtrihej. Nëse do t'ia shtronin, ai do të shtrihej, e nëse nuk shtronin gjë, ai do të shtrihej në tokë.

Allahu Teala, ende pa e dërguar Muhammedin a.s., si peygamber, në rreshtin e parë të Tevrat-it thotë: ***“Muhammedi është i dërguari (resuli) Im dhe Robi Im i përzgjedhur.”***

Nuk ishte i vrazhdë dhe i sertë. Nuk shëtiste shumë nepër rrugë, të keqen nuk e kthente me të keq, por falte dhe kthente më të mirë. Në Meke lindi, në Medine ndërroi jetë. E njihte mirë rajonin e Shamit. Vishte *Izar* (shami-mbulesë), si veshje e arabëve. Ai dhe ata rreth tij janë lidhur për Kur'an dhe dituri. Kur merrnin abdes, pastronin të gjitha pjesët. Siç është përshkruar në Tevrat, ashtu është përshkruar edhe në Ungjill.

Nga ahlaku i bukur të tij ishte të jep selam i pari. Nëse dikush në nevojë kërkonte diçka, ai i'a plotësonte nevojën. Nëse dikush do t'ia shtrëngonte dorën, ai nuk do ta tërheqte dorën derisa personi tjetër i pari të largojë dorën.

Kur takonte dikë nga as'habët, ai i pari do të shtrinte dorën për përshëndetje. Do ta merrte për dore dhe do ta shtrëngonte.

Me bismilah ulej dhe me bismilah ngrihej. Kur ishte me namaz, nëse dikush hynte brenda, namazin e shkurtonte, kthehej nga ai i cili kishte ardhur dhe e pyeste atë se a ka nevojë për ndonjë gjë. Kur i përmbushte nevojat e personit, ai i kthehej namazit.

Zakonisht rrinte ulur duke i mbledhur këmbët dhe duke i shtrirë duart mbi to. Vendi ku ai ulej nuk dallonte nga vendet e as'habëve të tjerë, për arsye se ulej aty ku kishte vend të lirë, për të mos i ngushtuar të tjerët. Asnjëherë nuk është parë në mesin e as'habëve se si i shtrinte këmbët, vetëm atëherë kur kishte vend të mjaftueshëm, atëherë i shtrinte. Ulur rrinte kryesisht i drejtuar kah kibla.

Nderonte secilin mysafir që i vinte, deri në atë masë sa edhe rrobat e veta ia dhuronte. Jastëkun e tij që e kishte i' a ofronte mysafirit të ulej në të. Në rast se mysafiri refuzonte, ai insistonte derisa mysafiri pranonte. Aq singertë sillej ndaj personit i cili vinte te ai, sa që ai person mendonte se është më i dashuri tek Resulallahu s.a.v.s..

Çdokujt që gjindej në mexhlis veç-e-veç i drejtohej dhe ia ofronte atë që e meriton nga dituria. Ndaj çdokujt drejtohej, bisedonte me të, veç-e-veç pyeste për gjendjen dhe situatën e secilit.

Mënyra se si ulej, dëgjonte, fliste, mënyra e të drejtuarit dhe mirësjellja e tij ishte shumë e singërtë. Megjithatë mexhlisi i tij ishte një mexhlis i edukimit, urtësisë, modestisë dhe kënaqësisë shpirtërore. Nërsa Allahu Teala thotë:

“Në saje të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhammed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje.” 3-Ali Imran: 159

As’habët e tij i thërriste me pseudonime. Pseudonime u vinte edhe atyre që nuk kishin, dhe sipas atij pseudonimi që Resulallahu a.s., u jepte, edhe të tjerët i thërrisinin po ashtu. Pseudonime u vinte edhe grave të cilat kishin fëmijë, derisa edhe atyre që nuk kishin fëmijë u vinte pseudonime. Kështu bënte edhe me fëmijët, në mënyrë që t’i gëzonte zemrat e tyre.

Nga të gjithë njerëzit më së vështiri zemërohej, e shumë shpejtë kënaqej. Mes njerëzve ishte më bujari, nga të gjithë të tjerët më i miri dhe më i hairit. Në shoqërinë e tij nuk ngriheshin zërat.

Kur ngritej prej mexhlisit thoshte:

**“Allahu im, vetëm Ty të falënderoj.
Dëshmoj se nuk ka ilah tjetër përveç Teje. Ty
të bëj teube dhe prej Teje kërkoj falje.”¹⁴,**
e më pas thoshte se këto fjalë i’a kishte
mësuar Xhibrili, a.s..

¹⁴ Hadithin e transmeton Nesai dhe Hakim në *‘Mustedrek’*

FJALIMI DHE BUZËQESHJA E TIJ

Resulallahu s.a.v.s., ishte njeriu më i qartë në të folur, dhe tejet i ëmbël kur fliste. Vet ka thënë:

“Unë jam më i qartë në të folur në mesin e Arabëve.”¹⁵

Edhe banorët e Xhennetit do të flasin me theksin dhe dialektin e Muhammedit, s.a.v.s.. Nuk fliste shumë, por pak dhe i përmbledhur, fjalët e tij ishin si perla të radhitura një nga një. Ndërsa Aisha r.anha., ka thënë:

“Ai nuk i shtonte fjalët njëren pas tjetrës, si ju. Fjalimi i tij ishte i shkurtër, e ju tani kur të flisni, flisni shumë (e teproni).”

Edhe kanë thënë - ai ishte njeriu që fliste në thelb, në fjali të shkurtër përmbledhte gjithë atë që kishte për qëllim të thoshte. Fliste me përmbajtje dhe ishte i qartë. As nuk e tepronte as nuk fliste pak. Fjalët e përcjellnin njëra-tjetrën, por bënte

¹⁵ Teberani në *‘Kebirin’* e tij nga Ebu-Seid el-Hudri dhe Hakimi nga Omeri r.a.. Hadith me kuptim të njëjtë transmeton edhe Ibn Ebu ed-Dunja.

pushime të shkurtëra, në mënyrë që të mbanin në mend ata që e dëgjonin.

Ishte fjalëdrejtë dhe me zërin më të këndshëm nga të gjithë njerëzit. Ishte i heshtur. Fliste vetëm atëherë kur ishte e nevojshme. Nuk fliste gjëra të panevojshme. Të drejtën e thoshte si kur ishte i hareshëm edhe atëherë kur ishte i zemëruar. Largohej nga ai, fjalimi i të cilit nuk ishte i pëlqyeshëm. Kur ishte nevoja të fliste për diçka që nuk e pëlqente, fliste me aludim. Kur nuk fliste, flisnin as'habët. Me të në bisedë nuk kishte grindje. Ishte serioz edhe kur jepte këshilla dhe thoshte:

“Mos e mohoni Kur’anin me Kur’an. Ai është shpallur në shumë kuptime.”¹⁶

Ishte njeriu që më shumti buzëqeshte karshi as'habëve të tij. Për të qenë të kënaqur ata, me admirim dëgjonte fjalët e tyre. Herë pas here buzëqeshte aq sa i shiheshin dhëmbët. Edhe as'habët duke iu përshtatur atij, në biseda rrinin të buzëqeshur dhe kënaqur.

¹⁶ Tebarani nga Abdullah b. Omeri. Poashtu Buhariu dhe Muslimi transmetojnë nga Omer ibnul-Hattabai se si Kur’ani është shpallur në shtatë mënyra.

Tregohet se si një ditë i ka ardhur një beduin, për ta pyetur rreth një çështje, derisa Resulallahu s.a.v.s., ishte i mërzitur. As'habët i thanë:

“Lëre, sot mos pyet, Resulallahu s.a.v.s., është i mërzitur.” Beduini tha:

“Më lejoni! Unë nuk do ta lë atë, derisa të buzëqeshë.” Më pastaj i tha:

“O i Dërguari i Allahut, dëgjuam se si Dexhalli do të ju vije njerëzve me tirid¹⁷ pranë vetes e do të ushqejë njerëzit, e njerëzit që nuk do të hanë do të vdesin nga uria. O ti që më je më i dashur se nëna e babai, më thuaj, çfarë të bëj? Nëse unë takohem me të (Dexhallin), a të vdes nga uria duke mos ngrënë, apo të ha derisa të ngopem e të trashem, e më pastaj të besoj në Allah, dhe të heq dorë nga ai?” Në atë, Resulallahu, s.a.v.s., qeshi aq shumë sa iu shfaqën dhëmbët, e tha:

“Jo, tij mos ha nga ajo, Allahu Teala ty nuk do të mbytë nga uria.”¹⁸

¹⁷ Përshesh copash buke me lëng mishi

¹⁸ Në hadithet e dëshmuara theksohet vetëm se si Dexhalli do të ketë një mal me bukë dhe një lum më ujë (dmth. shumë ushqim), e në hadith që shënohet nga Muslimi, pranë bukës përmendet edhe mishi. Poashtu, që të dy,

Thuhet se si Resulallahu a.s., nga të gjithë njerëzit ishte më fytyrë qeshuri. Ka qenë një shpirt i butë, vetëm kur i vinte Shpallja, kur fliste për ditën e Gjykimit apo ju tërheqte vërejtjen njerëzve në hudbe i ndërrohej fytyra. Kur ishte i lumtur dhe gëzohej, asnjëri nuk e kishte kënaqësinë si të tij. Ndërsa *va'zi* (këshilla) i tij ishte shumë serioz. Ai hidhërohej vetëm për Allahun, dhe në gjendje të hidhërimit nuk bënte asgjë. Ashtu ishte edhe në të gjitha qështjet tjera. Kur përballej me vështirësi thoshte: **“Lahavle vela kuvvete illa billah”**, dhe i'a linte Allahut, prej Tij kërkonte shpëtim. Pastaj kështu bënte dua:

“Allahu im, ma trego të vërtetën si të vërtetë që unë t'i përshtatem asaj. Ma trego të keqen si të keqe dhe bëj të jem larg nga ajo. Mos më lejo që pasionin tim të fillojë ta përcjelli pa udhëzimet e Tua. Pasionin tim bëje të bindet dhe të bëhet i dëgjues ndaj Teje. Më drejto në zbatimin e urdhërave Tua. Ti je Ai i Cili e dërgon atë që dëshiron në rrugë të drejtë.”

edhe Buhariu dhe Muslimi, shënojnë nga Huzejfe dhe Ebu Mesud se pos ujit do të kenë edhe zjarrin.

EDEBI DHE AHLAKU I RESULALLAHUT S.A.V.S. NË TË USHQYER

Resulallahu s.a.v.s., ushqehej me atë që kishte. Më së shumti i pëlqente të hante me masën, nga shumë duar (kallaballëk).

Kur shtrohej sofrë, lutej:

“Bismil’lah (Me emrin e Allahut), Allahu im, bëje këtë ushqim të dobishëm dhe atë që do të jetë falënderues, bëje që me të të arrijë nimetet e Xhennetit.

Shumë shpesh, kur ulej të hante, ulej ashtu siç ulet në namaz, duke thënë:

“Unë jam rob. Ha si rob e ulem si rob.”¹⁹

Nuk e hante ushqimin e nxehtë. Thoshte:

“Ai (ushqimi i nxehtë) është pa bereqet. Allahu nuk na ushqen me zjarr. Për këtë arsye lëreni të ftohet!”²⁰

¹⁹ Hadithin e transmeton Bezzariu.

²⁰ Bejhaki nga Ebu Hurejre r.a.

Hante atë ushqim që i gjendej para vetes. Hante me tre gishta. Nganjëherë i përdorte edhe katër gishtat. Me dy gishta nuk ka ngrënë. Për atë mënyrë të të ushyerit thoshte:

“Ajo është ushqyerje e shejtanit.”²¹

Një ditë, Osmani r.a., i solli gjellë paluze Resulallahut s.a.v.s.. Duke ngrënë, Resulallahu s.a.v.s., e pyeti:

- O Ebu Abdullah, çfarë është kjo? Si e bëni këtë? Osmani r.a., tha:

- Ja Resulallah, ti që më je më i dashur se nëna e babai. Yndyrë me mjaltë vendoset në tavë, të cilën më pas e vendosim në zjarr, derisa shkrihet. Pastaj e marrim grurin kokërr të bluar dhe e zhysim në tavë, e përziejmë derisa të bëhet gati kështu siç po e sheh - bëhët si hallvë. Në këtë, Resulallahu a.s. i tha:

- Me thënë të drejtën, kjo është një gjellë e mirë.²²

²¹ Darekutni në *‘El-Ifrad’* nga Ibn Abasi.

²² Ibn Maxhe nga Ibn Abbasi.

Resulallahu, a.s., hante bukë nga mielli i elbit. Poashtu, hante tranguj me hurme të freskëta dhe me kripë. Nga pemët më së shumti i pëlqente hurme të freskëta, pjepër, shalqi dhe rrush. E ka pasur si zakon që shalqinin ta hante me sheqer dhe me bukë, dhe herë-herë edhe me hurme të freskëta. Pjepërin dhe shalqirin e hante me të dy duart.

Hante hurme me dorën e djathtë, derisa në dorën e majtë mbante farat. Aty afër kalonte delja dhe i drejtoi farat drejt saj. Delja filloi të hante nga dora e tij e majtë, derisa vetë hante me dorën e djathtë, derisa nuk përfundoi dhe delja u largua.

Nganjëherë rrushin e hante një nga një, në mënyrë që prej mjekrës së tij pikonte uji i rrushit sikur të ishin perla.

Ushqimi i tij kryesisht përbëhej nga uji dhe hurmet. Qumështin dhe hurmet i bënte bashkë dhe këto të dyja i quante ushqimin më të mirë. Ushqimin më të preferuar e kishte mishin.

Thoshte:

“Mishi rrit dëgjimin e veshit. Mishi është ushqim i mirë në dynja dhe ahiret. Sikur të kërkoja nga Rabbi im që ai të më ushqente me të çdo ditë, Ai do t’a bënte një gjë të tillë.”²³

Gjellën tirid e hante me kungull. Kungullin e donte, dhe për të thoshte:

“Kungulli është perime e vëllait tim Junusit Alejhisselam.”²⁴

Aisha r.a., rrëfen se si Resulallahu a.s., i thoshte:

“Oj Aishe, kur e vendosni tenxheren që të zihet, në tenxhere fut më shumë kungull. Ngase kungulli përforcon zemrën.”²⁵

Poashtu, hante edhe mishin e zogut i cili kapej në gjueti, edhe pse ai vet nuk merrte pjesë në gjueti, e pëlqente që t’i sjellej ndonjë pjesë nga ajo dhe ta hante. Kur e hante mishin, nuk e përkulte kokën drejt saj, por vetëm e ngrinte drejt gojës dhe pastaj e hante. Bukën e hante me gjalpë. Nga delja i

²³ Ebu’sh-Shejh nga Ibn Sema.

²⁴ Ibn Maxhe nga Enesi, r.a.

²⁵ Hadithi është cekur në **‘Fevaid’** të Ebu Bekir esh-Shafisë.

pëlqente kërci nën gju dhe supi, nga ushqimi i zier kungulli, nga mëlmesat uthullën, i pëlqente hurma Axhva dhe për këtë hurme bënte dua për bereqet duke thënë:

“Kjo hurma është nga frytet të Xhennetit. Karshi helmit dhe sihirit (magjisë) është ilaç.”

Nga bishtajoret i pëlqente *astragalus* (bime halore) dhe *portulacca* (burdullak).

Nuk hante hudhër, qepën e kuqe dhe purrinë. Asnjëherë nuk e zgjidhte ushqimin. Nëse i pëlqente, e hante, e nëse nuk do t'i pëlqente, do ta linte. Nuk i pëlqente shpretka, edhe pse nuk ndaloi që të konsumohet.

Me gishta e fshinte pjatën, duke thënë:

“Pjesët e fundit të ushqimit sjellin më së shumti bereqet.”²⁶

E në fund lëpinte gishtat e vet. Nuk i fshinte duart me leckë derisa nuk e lëpinte secilin gisht, duke thënë:

“Nuk dihet se në cilën pjesë të ushqimit është bereqeti.”²⁷

²⁶ Bejheki transmeton hadithin në *‘Shuabu-iman’* nga Xhabiri, r.a.

²⁷ Muslimi nga Ka’ba ibn Malika dhe Xhabira, r.a. Hadithin me këtë kuptim transmeton Bejhekiu.

Kur përfundonte me ushqim, thoshte:

“Allahu im, gjithë lavdërimet dhe falënderimet janë vetëm për Ty, na ke ushqyer dhe na ke ngopur, na ke shuar etjen dhe na ke kënaqur, Ty të falënderojmë, nuk jam mos-mirënjohës, nuk braktisi falënderimin, dhe gjithmonë do të falënderoj Ty.”²⁸

Posaqërisht kur hante bukë me mish, i lante duart mirë dhe me pjesën e mbetur të ujit e fërkonte fytyrën.

Kur pinte, pinte me tri gëllnjëka, çdoherë fillonte me bismil’lah dhe përfundonte me falënderim (hamd). Ujin e pinte me ngadalë, jo përnjëherë. Ajo çfarë mbetej nga pija, i’a jepte personit nga ana e tij e djathtë. Nëse dikush ulej nga ana e tij e majtë, e që ishte i në pozitë më të lartë (se personi në të djathtë), i thoshte personit nga e djathta e tij:

“Është synet që të të jepet ty, por nëse ti do, ti mund t’i japësh përparësi atij.”

²⁸ Taberani nga Haris b. Haris. Nga ana tjetër, Buhariu transmeton nga Ebu Umame në të cilin qëndron se Resulallahu s.a.v.s., ka bërë dua të ngjashme me atë të mësipërmen.

Me siguri se nganjëherë ka pirë edhe me një gëllënjë të vetme, të gjithën, deri në fund. Nuk frynte në enën nga e cila pinte, dhe vetëm pasi e lagonte gotën nga goja, merrte frymë.

Njëherë e sollën një gotë, plot me mjaltë dhe qumësht, dhe duke refuzuar ta pijë tha:

“Dy ëmbëlsira dhe dy sherbetë së bashku nuk bëhet”, e më pastaj tha:

“Nuk u’a ndaloj, por nuk mburrem me gjëra kalimtare të dynjallëkut, sepse nuk e shoh si të përshtatshme kur mendoj për llogarinë që duhet dhënë të nesërmen. Unë e dua thjeshtësinë dhe modestinë. Ata të cilët janë të përvulur për Allahun, Allahu Teala i lartëson.”²⁹

Në shtëpinë e tij ishte më i turpshëm se skllavi në liri. Nuk ju bënte zullum bashkëfamiljarëve me dëshirat për ushqim. Nëse do t’i jepnin të hante diç, do të hante. Atë që i ofronin - atë edhe e hante. Kur i ofronin për të pirë, ai pinte. Herë pas here edhe vetë ngritej dhe përgatiste ushqim dhe pije për vehte.

²⁹ Bezzar nga Talha.

MIRËSJELLJA (EDEBI) DHE AHLAKU I RESULALLAHUT S.A.V.S., NË VESHJE

Resulallahu s.a.v.s., veshte atë që kishte: *izar*³⁰, këmishë, xhybe e kështu me radhë.

I pëlqenin rrobat e gjelbra, ani pse më së shumti vishte ngjyrë të bardhë. Për rrobat e bardha thoshte:

“Në te i veshni të gjallët tuaj, dhe në te i mbështjellni të vdekurit!”³¹

Vishte edhe rroba të qëndisura, si në beteja ashtu edhe me qëllim tjetër. I posedonte në pëlhurë të hollë e të pambuktë dhe i përshtatej jashtëzakonisht me bardhësinë e fytyrës së tij. Të gjitha rrobat e tij nuk kalonin thembrën e këmbës. Izari ishte edhe më sipër.

Këmisha ishte e mbërthyer me pulla. Pullat spesh i shpërthekonte kur ishte në namaz apo në raste të tjera. E kishte edhe një

³⁰ Veshja me të cilën mbulohet trupi, prej gjoksit deri poshtë.

³¹ Ibn Maxhe dhe Hakim nga Ibn Abbasi me një varg transmetuesish të besueshëm.

mbulesë të ngjyrosur me safran. Shpesh me njerëzit falej vetëm në të, por shpesh ishte vetëm në mbulesë. E kishte edhe rroba shajaku të cilin e vishte, dhe thoshte:

“Unë jam rob dhe vishem si rob.”³²

Pos veshjes që e vishte, ka pasur edhe dy palë rroba vetëm për xhuma. Ndonjëherë e vishte vetëm izarin duke i lidhur skajet e tyre në supe, dhe në atë ju falte njerëzve xhenazen. Kur ishte në shtëpinë e tij falej vetëm nën një izar dhe ky izar ishte në trupin e tij gjatë marrëdhënies. Në më të shumtën e rasteve, natën falte vetëm nën një izar. Kjo domethënë është një çarçaf. Me një pjesë mbështjellte veten, derisa pjesën e dytë e hidhte përreth gruas, dhe ashtu falej.

Resulallahu, a.s., e kishte një rrobë të leshtë të zezë, të cilën e dha si dhuratë. Kur Ummu Selema e pyeti:

- *Çfarë u bë me ato rroba të zeza? Kurrë diçka më të mirë nuk kam parë nga bardhësia jote në atë të zezë!* Resulallahu a.s., tha:

- I’a fala njërit.

³² Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Burde.

Enesi r.a., thotë:

- *Ka ndodhur që na ka falur namazin mbështjellur në qilim të hollë.*

Resulallahu s.a.v.s., mbante edhe unazë në gisht. Në unazë e lidhte një pé e cila e kujtonte në diçka të caktuar. Në unazë ishte shkruar: **‘Muhammedu’r-Resulullah’** dhe me të i vuloste letrat e tij duke thënë:

“Vula në letër është me e mirë se dyshimet.”³³

Nën çallmë e vinte kësulën. Atë e mbante edhe pa çallmë. Shumë shpesh kësulën e hiqte nga koka dhe e linte pranë vehtes si perde dhe falte namazin. Shumë shpesh ishte edhe pa çallmë duke e mbështjellur një shami rreth kokës dhe ballit.

E kishte një çallmë që quhej *‘Sehab’* (re). Atë i’a fali hazreti Aliut r.a. Sa herë që hazreti Alia r.a. shkonte me këtë çallmë të Resulallahu s.a.v.s., i Dërguari a.s., thoshte:

“Ju erdhi Alia me sehab (retë).”³⁴

³³ Buhariu dhe Muslimi nga Enesi, r.a.

³⁴ Ibn Adijj dhe Ebu’sh-Shejh transmeton nga Xhaferi ibn Muhamed, ai nga babi I tij, dhe ky nga gjyshi i tij. Nga ana

Kur i vishte rrobat, Resulallahu s.a.v.s., e bënte atë nga ana e djathtë, duke thënë:

“Falënderoj Allahun, i cili më veshi me të që të mbulojë pjesën time të turpshme dhe që në mesin e njerëzve të dukem bukur.”³⁵

Dhe kur i hiqte rrobat, ai e bënte atë nga ana e majtë. E kur i vishte rrobat e reja, të vjetrën u’*a* dhuronte të varfërve. Thoshte:

“Ai që për rizanë e Allahut e vesh një të varfër me rroba të përdora, Allahu Teala e vendos nën mbrojtjen e Tij, nën sigurinë dhe mirësinë e Tij, përderisa i përdorë këto rroba i varfëri, pa marrë parasysh gjallë apo i vdekur (pra, si qefin).”³⁶

Resulallahu a.s., kishte dyshek të lëkurës të mbushur me fletë të palmës, me gjatësi të dy bërrylave dhe gjerësi një bërryl e një hapësirë, apo përafërsisht aq. E kishte

tjetër, Ebu Nuajm shënon në *‘Delailu’n-Nubuvve’* hadithin ku përmendet çallma e të Dërguarit, a.s., me emrin Sehāb.

³⁵ Shënon Tirmidhiu. Hadithin e transmeton edhe Ibn Maxhe dhe Hakimi nga Omer b. Hattabi r.a., derisa Hakimi thotë se hadithi është i besueshëm

³⁶ Hakimi në *‘Mustedrek’* dhe Bejhekiu në *‘Shuab’* nga Omeri r.a.

edhe një *aba*³⁷ të cilin e shtronte për t'u ulur kur shkonte në një vend. Ndërkohë flinte në hasër pa asgjë në të.

Në etikën e tij ishte edhe vënia e emrave shtazëve të tij, armëve dhe mjeteve. Kështu flamuri i tij quhej *Ukab*, e shpata me të cilën shkonte në beteja *Zulfikar*. E kishte edhe një shpatë që e quante *Muhazzem*, njërën me emrin *Resub*, si dhe një shpatë tjetër më emrin *Kadhib*. Dorëza e shpatës së tij ishte e përpunuar me argjend.

Ka pasur një rrip nga lëkura me tre hallkë nga argjendi. Harku i tij quhej *Ketum*, kurse mbajtësen për shigjeta e kishte emëruar *Kafur*.

Devja i quhej *Kasva* (me një majë të veshit të prerë), ajo për të cilën thuhet *adba* (vesh i prerë). Mushka i quhej *Duldu*³⁸ gomari *Ja'fur*³⁹, e delja nga e cila pinte qumështin *Ajna* (syri).

³⁷ Iloj stofi i punuar trashë dhe në mënyrë primitive; shajak

³⁸ Emri i mushkës që Resulallahu s.a.v.s., ia dhuroi Imam Alisë. Përdoret në formë shakaje për kuajt e këqij, fig. automobil i vjetër, makinë lodër.

³⁹ Gazelë në ngjyrë dheu, këlysh gazele, 1/5 ose 1/6 pjesë e natës.

E kishte edhe një enë nga balta nga e cila merrte abdes dhe pinte ujë. Njerëzit i dërgonin fëmijët e tyre të cilët veçse ishin të vetëdijshëm, dhe ata hynin në shtëpinë e Resulallahut, s.a.v.s., dhe një gjë e tillë nuk i'u mohoj. Kur gjenin ujë në enë, e merrnin ta pinin dhe e derdhnin nëpër fytyrë dhe në trup. Me këtë ata merrnin bereqet.

FALJA E RESULALLAHUT S.A.V.S., ANI PSE KISHTE FUQI PËR HAKMARRJE

Resulallahu, s.a.v.s., ishte njeriu më i butë,⁴⁰ më i prirur për falje, edhe pse i mjaftonte fuqia për t'u hakmarrë. Një herë, i sollën qaforet nga ari dhe argjendi, e ai i ndau në mes as'habëve të tij brenda parimeve themelore. Natyrisht, të gjithëve nuk u dha në sasi të barabartë. Me këtë rast, një beduin u ngrit dhe tha:

- *O Muhammed, vallahi, Allahu të ka urdhëruar të jesh i drejtë! Unë nuk po e shoh se je i drejtë.* Në këtë Resulallahu, a.s., tha:

- **I mjeri ti, kush do të jetë i drejtë për ty pos meje?!** Pastaj, kur personi u largua nga aty, Resulallahu s.a.v.s., tha:

- **Ma thirrni atë person përsëri, pak më pas.** Edhe pas një sjelljeje aq të ashpër dhe të pa edukatë të personit, atij me fjalë të ëmbla ia tërhoqi vëmendjen, e thirrja më pas ishte që të mos frikësohet personi.⁴¹

⁴⁰ Hadithi për këtë veçse është theksuar

⁴¹ Hadithin transmeton Ebush-Shejh nga Ibn Omeri, me një varg pasuesish të mirë.

Xhabiri r.a., transmeton se Resulallahu, a.s., u ndau njerëzve në ditën e Hajberit argjendët e mbledhur në rroba të Bilallit. Gjatë kësaj kohe një njeri po i thotë:

- *O i Dërguar i Allahut, ndarjen bëje drejtë!*” Resulullahu në atë u përgjigj:

“I mjeri ti, nëse unë nuk veproj drejtë, atëherë kush mundet të veprojë drejtë? Atëherë në këtë çështje do të dëmtohesha! Prandaj si nuk jam i drejtë?”

Në atë çast u ngrit hazreti Omeri r.a., dhe tha: *“Ky është munafik, t’ia prej qafën!”* Resulullahu, a.s., tha:

“Neudhubillah, e më pastaj njerëzit të flasin se si i vras as’habët e mi!”⁴²

Në njërën nga betejat, armiku e shfrytëzoi pakujdesinë e myslimanëve dhe duke i’u afruar Resulallahut s.a.v.s, me shpatë në dorë, i tha:

“Kush do të mbrojë tash nga unë?” Resulullahu a.s., tha:

“Allahu.” Njeriut i ra shpata nga dora, e mori Resulullahu, a.s., dhe tha:

⁴² Hadithin e transmeton Muslimi.

“E kush do të mbrojë ty tash nga unë?” Ai në këtë i’a ktheu:

“Ti bëhu më i mirë se unë, falëm mua!”

Resulullahu, a.s., atëherë tha:

“Thuaj: Dëshmoj se nuk ka ilah tjetër përveç Allahut dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i dërguar i Allahut. (*“Eshhedu en la ilahe illallah ve eshhedu enne Muhammeden abdu-hu ve resuluh.”*). Njeriu tha:

“Jo, këtë nuk mundem të them. Mund vetëm të them se më nuk do të luftoj kundër teje, por nuk do të jem as me ty e as me ata që luftojnë kundër teje.” Me këtë Resulullahu, a.s., e lëshon të lirë. Njeriu shkoi tek njerëzit e vet dhe u tha:

*“Po vij nga takimi me njeriun më të mirë”.*⁴³

Enesi, r.a., transmeton se si një çifute ia solli Resulallahut, a.s., një dele të helmuar që të hajë mish nga ajo. Kur e kapën dhe e sollën tek Resulullahu s.a.v.s., dhe ai e pyeti pse kishte bërë diçka të tillë, ajo u përgjigj:

⁴³ Shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

“Kam dashur të të vras.” Atëherë i Dërguari, a.s., i tha:

“Allahu nuk ta mundësoi një gjë të tillë.” As’habët kërkuan që t’a ekzekutojnë, ndërsa ai u tha:

“Lëreni të shkojë.”⁴⁴

Njëherë, Resulallahut s.a.v.s., i bëri sihir (magji) një çifut, andaj Xhibrili, s.a.v.s., e lajmëroi për këtë, e më pastaj e nxori magjinë, e liroi, dhe ndjeu një lehtësim. Asnjëherë nuk i’a tha këtë çifutit, dhe nuk i tregoi asnjëherë.⁴⁵

Hazreti Alia r.a., rrëfen:

“Resulallahu, s.a.v.s., na dërgoi mua, Zubejirin dhe Mikdadin, duke na thënë:

- Shkoni derisa të mbërrini në bahçen ‘Hab’. Aty do të gjeni një grua të martuar. Tek ajo është një shënim. Merreni nga ajo!

Kështu ne u nisëm derisa arritëm tek bahçeja “Hab”. I thamë asaj gruas:

- Na jep shënimin!

⁴⁴ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre r.a.

⁴⁵ Hadithi për këtë transmeton Nesai nga Zejdi ibn Erkami., në kuptimit të njëjtë gjendet tek el-Buhari dhe Mulsima nga Aishe r.a.

Derisa ajo na thoshte se s'ka asnjë shënim, ne i thamë:

- Do ta nxjerrësh ti apo do t'i zhveshim rrobat!

Më pastaj ajo e nxori nga gërsheta e flokëve. E sollëm tek Resulullahu s.a.v.s., e në atë shënim Hatib ibn Ebi Belta' u shkruante disa mushrikëve në Mekë, duke i lajmëruar për disa punë të Resulallahut s.a.v.s.. Resulallahu s.a.v.s., e pyeti:

*- **Çka është kjo Hatib?!,** e ai tha:*

- O i Dërguar i Allahut, mos hezito! Kam mbajtur lidhjet me popullin tim. Disa nga muhaxhirët tuaj kanë pasur të afërm në Mekë, të cilët ju kanë mbrojtur familjet. Andaj dëshirova, për arsye se nuk kam asnjë lidhje familjare, që të më bëjnë një nder dhe të m'i ruajnë të afërmit. Nuk e kam bërë këtë nga mosbesimi e as me dëshirë, pasi që e kam pranuar Islamin, e as për t'u larguar nga besimi im.

Në këtë Omeri r.a., tha:

- O i Dërguri i Allahut, më lejo që t'ia këpus kokën këtij mynafikut. Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- Ai ishte në Bedër. Ku ta dijmë?
Allahu Teala për luftëtarët e Bedrit thotë:
‘Bëni çfarë të doni, unë veçse ju kam
falur!’⁴⁶

Njëherë, Resulallahu, a.s., bënte
shpërndarjen e *ganimetit*, kur një njeri nga
ensarët tha:

*“Kjo shpërndarje nuk përputhet me
rizanë e Allahut.”*

Kur e lajmruan për këtë, Resulallahut
s.a.v.s., iu skuq fytyra, dhe tha:

**“E mëshiroftë Allahu Teala vëllaun tim
Musanë! E kanë shqetësuar edhe më shumë
se kjo, por u tregua i durueshëm.”⁴⁷** Më pas,
Resulallahu s.a.v.s., tha:

**“Mos të më lajmrojë asnjëri nga ju për
bisedat kundër cilit do nga as’habët e mi!
Dëshiroj që në mesin e juaj të jem me
kënaqësi.”⁴⁸**

⁴⁶ Shënojnë Buhariu dhe Muslimi

⁴⁷ Buhariu dhe Muslimi nga Ibn Mesudi r.a.

⁴⁸ Ebu Davud dhe Tirmidhiu nga Ibn Mesudi r.a.

SI RESULALLAHU S.A.V.S., E MBYLLI SYRIN NGA AJO QË NUK E PËLQENTE

Resulallahu, s.a.v.s., kishte lëkurë të butë, i bukur dhe i këndshëm, nga brenda dhe nga jashtë. Në fytyrë i njihej hidhërimi dhe gëzimi. Kur mërzitej, më shumë do të lëmonte mjekrrën. Kur nuk i pëlqente diçka, nuk e përkrahte. Njëherë i erdhi një njeri me fytyrë ngjyrë të verdhë, dhe kjo nuk i pëlqeu. Por nuk i tha derisa njeriu u largua. Kur u largua u tha disave:

“Sikur ta kishit këshilluar që t’a heq atë ngjyrë, kishte me qenë më mirë!”

Një beduin në praninë e tij filloi që të urinonte në një qoshe të xhamisë. As’habët u vërsulën drejt tij, e Resulallahu, s.a.v.s., u tha:

“Mos e ndërpreni” (derisa të kryej urinimin), e më pastaj tha:

“Nuk ka hije në xhami papastërtia, si urina dhe jashtëqitja. Në një transmetim tjetër:

“Afroni (njerëzit), e mos i bëni që të ndjejnë urrejtje.”⁴⁹

⁴⁹ Buhariu dhe Muslimi nga Enesi r.a.

Njëherë i erdhi një beduin duke kërkuar nga ai që t'i japë diçka. Resulullahu, s.a., i dha dhe e pyeti:

- **A je i kënaqur?** Beduini tha:

- *Jo, nuk jam i kënaqur edhe nuk bëre gjë të mirë.* Muslimanët që ishin prezent në atë mexhlis u mllefosën në fjalët e tij dhe i'u vërsulën, por Resulullahu a.s., u dha shenjë që të mos e prekin. Pastaj, u largua nga mexhlisi dhe hyri në shtëpinë e vet. Pas një kohe të shkurtër e ftoi beduinin, i dha edhe diçka, dhe prapë e pyeti:

- **Tani, a je i kënaqur?** Beduini u përgjigj:

- *Po, tani jam i kënaqur, Allahu të shpërbleftë me të mira, familjen dhe të afërmit!* Resulallahu s.a.v.s, tha:

- **Më parë e the atë që e the, derisa as'habëve ju erdhi shumë rëndë kur e dëgjuan, andaj nëse don shko, dhe thuaj para tyre ato fjalë që më the mua në mënyrë që të nxjerrësh nga gjoksi i tyre tërë atë mllef që kanë ndaj teje.**

Beduini tha se do ta bëjë. Të nesërmen në mëngjes ai erdhi prapë në mexhlis, dhe Resulullahu, a.s., tha:

- Ky beduin e tha atë që e tha, dhe ne i dhamë më shumë. Unë mendoj se tani është i kënaqur. A nuk është ashtu? Beduini u përgjigj:

- *Po, Allahu të shpërbleftë me të mira familjen dhe të afërmit!"* Resulallahu s.a.v.s. më pastaj tha:

- Shembulli im dhe i këtij beduini është sikur shembulli i atij që i kishte ikur deveja. Njerëzit fillojnë t'a ndjekin devenë për t'a kapur, e kjo bën që ajo edhe me shumë të largohej. Më pastaj pronari i devës thotë:

- *Lëreni, mos e ndjekni. Na lini vetëm mua dhe devenë time. Unë me devenë kam qenë më i mëshirshëm dhe e njoh më së miri.*

Ai më pastaj merr një tufë bar në dorë dhe fillon të thërrasë devenë dhe deveja dalngadalë afrohet dhe përkulet pranë tij, e më pastaj ai e përgadit dhe i hip. Sikur t'ju lija që ta dënoni atë njeri për shkak të asaj çfarë tha, e ju ta vrisnit, beduini do të shkonte në Xhehenem.⁵⁰

⁵⁰ Bezzar dhe Ebu'sh Sheh nga Ebu Hurejre r.a.

XHYMERTLLËKU (BUJARIA) E RESULALLAHUT S.A.V.S.

Resulallahu, s.a.v.s., ishte njeriu më i mirë dhe më bujar. Veçanërisht gjatë muajit të Ramazanit ai ishte si era që fryn dhe nuk le asgjë në dorë. Hazreti Alia r.a., kur e përshkruante Resulullahun s.a.v.s., thoshte:

“Ai ishte njeriu më bujar, shpirtmirë, krahëhapur, më i singerti dhe më i besueshmi, me një natyrë të butë dhe me një miqësi fisnike. Ai që e shihte rastësisht, ndjente një frikë-respekt ndaj tij, por kush e njihte më gjatë - e donte.”

Ai që përshkruante cilësitë e tij, do të thoshte:

‘Asnjëherë, as më parë e as më pas, nuk e kam parë dikë sikur ai.’

Çdo gjë që kërkohet nga ai, nëse ka e jepte, nëse ishte mundësia për t’a gjetur, jepte fjalën, nëse nuk ka mundësi për këtë, heshte. Njëherë, i erdhi një njeri duke kërkuar nga ai. Resulallahu, a.s., i dha një tufë dele aq sa u mbush qafa në mes të dy

kodrinave. Njeriu u kthye tek populli i tij, duke u thënë:

“Pranoni islamin, Muhammedi a.s., jep aq shumë sa që nuk ka frikë nga varfëria.”

Kur diçka është kërkuar prej Resulullahut s.a.v.s., kurrë nuk ka thënë ‘jo’. Njëherë i sollën 90 mijë dërhëmë, e ai i vendosi mbi hasër dhe filloi t’i shpërndante secilit që erdhi, derisa i përfundoi të gjitha, dhe pastaj shkoi.⁵¹

Të dëgjojmë një ngjarje që e rrëfen Hz. Omeri r.a.:

“Erdhi një fukara tek Pejgamberi s.a.v.s., edhe i kërkoi diçka. Por, atë që ai e kërkoi, Pejgamberi s.a.v.s., nuk e kishte. Kështu, Pejgamberi s.a.v.s., u mërzit shumë që nuk pati atë që i kërkoi fukaraja. Atëherë Pejgamberi s.a.v.s., i tha të shkojë në çarshi ta blente atë, të shënojë emrin e Pejgamberit s.a.v.s., si borxhli dhe t’i thotë shitësit se do t’i kthejë borxhin në mundësinë e parë që do t’i jipej. Ai kishte ndihmuar edhe më parë të

⁵¹ Dëshminë e kësaj e gjejmë tek Buhariu, hadithi i të cilit transmetohet nga Enesi, r.a.

njëtin person. Duke e ditur këtë, Hz. Omeri r.a., e pyeti: ‘Ja Resulallah, këtij personi i keni ndihmuar edhe më parë, a pati nevojë që t’ia plotësosh këtë kërkesë tani?’

Pejgamberi s.a.v.s., nuk ishte i kënaqur nga këto fjalë të Omerit r.a.; kjo u kuptua nga shprehja e fytyrës së tij. Në atë çast, njëri nga ensarët shprehi mendimin e tij: ‘Ja Resulallah, dhuro, se Allahu Teala që është mbizotërues i Arshit, nuk ju le juve të bini në varfëri.’ Resulallahut s.a.v.s., i pëlqeu mendimi i tij dhe u drejtua:

‘Unë jam urdhëruar të mos frikësohem nga të dhuarit dhe varfëria’.⁵²

Kur u kthye nga Hunejna, i erdhën beduinët duke kërkuar lëmoshë nga ai, derisa e mbështetën për një pemë. I’a shqyen edhe rrobat. Resulallahu, a.s., ndaloi dhe u tha:

- M’i jepni rrobat e mia! Sikur të kisha dele aq sa ka drunjë *Ummugajlan*, të gjitha me ju do t’i ndaja. Në këtë premtim nuk do të më shihni as koprrac, as rrenacak as frikacak.⁵³

⁵² Tirmidhiu në *‘Shemail’* nga Omeri, r.a.

⁵³ Buhariu nga Xhubejri.

TRIMËRIA E RESULALLAHUT S.A.V.S.

Resulallahu s.a.v.s., ishte njeriu më i guximshëm dhe më trim. Alia r.a., thotë:

“Ke mundur të na shohësh në ditën e Bedrit se si fituam përkrah Resulallahut, s.a.v.s., kur ai ishte nga të gjithë ne më afër armikut dhe atë ditë më i ashpri ndaj armikut.”⁵⁴

Poashtu tha:

“Kur beteja ashpërsohej e zgjerohej, dhe palët ndesheshin, ne u strehuam tek Resulallahu s.a.v.s., derisa nuk ishte askush më afër armikut tonë, se sa ai.”⁵⁵

Është thënë se si Resulallahu, a.s., pak fliste. Por, kur vinte koha e betejës, ai shpejtonte, niste urdhrat e luftës dhe vepronte me tërë fuqinë.⁵⁶ Ishte më guximtari. Trim ishte ai që i afrohej Resulallahut a.s. gjatë luftës, sepse ai qëndronte më së afërmi armikut.⁵⁷

⁵⁴ Ebu'sh-Shejh në *'Ahlakun-nebijjun'*

⁵⁵ En-Nesai me një varg pasuesish të besueshëm. Hadith të tillë transmeton edhe Muslim nga el-Berra

⁵⁶ Ebu'sh-Shejh nga Sada ibn Ijaz

⁵⁷ Muslim nga el-Berra.

Imran ibn Husein rrëfen:

“Kur Resulallahu, a.s.v.s., ndeshej me armikun, godiste i pari. Kishte fuqi të madhe.”

Kur iu afruan myshrikët, në betejën e Hunejn, ai zbriti nga mushka e tij, dhe tha:

“Unë jam Pejgamber, nuk ka gënjeshtër në këtë që them! Unë jam djali i djalit të (nipi i) Abdylmyttalibit.”⁵⁸

Atë ditë, askush nuk u pa të jetë më trim dhe më i fuqishëm sesa ai.

⁵⁸ Buhariu dhe Muslimi nga Enesi.

MODESTIA E RESULALLAHUT S.A.V.S.

Resulallahu s.a.v.s., edhe pse kishte pozitën më të lartë, ishte njeriu më modest.

Dukë pasur parasysh pozitën e tij të lartë, Resulallahu, a.s., ishte njeri që shfaqej me shumë modesti. Ibn Amiri na tregon:

“E kam parë në kohën e haxhit, mes njerëzve, se si nga deveja ngjyrë hiri gjuajnte guralecë (Xhemretul-Akabe) si të tjerët, nuk shtyente njeri.”

Hipte në gomar duke i’u vendosur kadifenë, dhe merrte në vithe të gomarit edhe dikë tjetër.

I vizitonte të sëmuarit, i përcjellte xhenazet dhe i përgjigjej thirrjes së skllavit, rregullonte mbathjet, harronte rrobat dhe së bashku me familjarët i bënte edhe punët e shtëpisë. As’habët pranë tij nuk ngriteshin si shenjë respekti, sepse ata e dinin se ai nuk e

pëlqente një gjë të tillë. Kalonte pranë fëmijëve dhe ju jepte selam.

Një ditë Resulallahu s.a.v.s., shkoi te një person, ai nga hejbet-i⁵⁹ i tij u frikësua e filloi të dridhej. Resulallahu s.a.v.s., i tha:

“Ngadalë, unë nuk jam mbret. Unë jam djali i një gruaje nga fisi Kurejsh e cila hante mish të terun.”⁶⁰

Ulej në mesin e as’habëve sikur të ishte njëri ndër ta. Kur vinte ndonjë i huaj, derisa pyeste nuk e dinte se cili ishte Resulullahu s.a.v.s.. Më në fund, as’habet e kuptuan që kjo nuk bën kështu dhe për Resulallahun s.a.v.s., u ndërtua prej balte një ulëse më e lartë, në të cilën ulej.

Aisha r.a., i thoshte:

“Ha duke u mbështetur! Kështu do ta kesh më lehtë.” Ai uli kokën aq sa e preku tokën, dhe tha:

“Jo, unë ha si rob, dhe ulem si rob.”⁶¹

⁵⁹ **Hejbet:** madhështia; gjendja që jep ndjenjën e frikës-respektit; madhëria

⁶⁰ Hakim nga Xheriri

⁶¹ Ebu’sh-Shjeh nga Abdullah ibn Ubejde.

Resulallahu s.a.v.s., nuk hante në tabaka të madhe, as nuk hante bukë të hollë e të pjekur mirë, dhe as nuk hante ndonjëherë në sofër ose në tavolinë.⁶²

Kushdo që e thërriste, i përgjigjej me *'lebbejk'* (urdhëro).

Kur ulej me njerëz, dhe ata fillonin të flisnin për ahiretin, edhe ai merrte pjesë, nëse do të bisedonin për ushqimin apo pijen, prapë do të merrte pjesë në bisedë, e nëse bisedonin për gjërat e dynjasë, edhe atëherë merrte pjesë, gjithnjë për ndjeshmërinë dhe modestinë që kishte ndaj tyre.

Ndonjëherë recitonte poezi si dhe i përmendte ngjarjet nga koha e xhahiletit (periudhës para-islame), dhe qesheshin të gjithë së bashku. Kur ata qesheshin, edhe ai qeshte. Nuk i ndalonte ata nga gjërat që nuk janë haram.

⁶² Buhariu nga Enesi r.a.

PAMJA DHE QËNDRIMI I RESULALLAHUT S.A.V.S.

Duke e përshkruar Resulallahun, s.a.v.s., transmetohet se nuk ka qenë shumë i gjatë, as i shkurtër. Kur ecte, është thënë të jetë vetëm ‘mesatar’. E megjithatë, kur ecte mes njerëzve, ai ishte më i gjatë. Resulallahu s.a.v.s., dukej më i gjatë nga të gjithë. Ndodhte që dy njerëz të gjatë kur rrethonin Resulallahun a.s., të duken gjer tek supi i Resulallahut a.s. Kur ecte vetëm ishte mesatarisht i gjatë. Thoshte:

“Gjithçka e mire që bëhet, është në mes.”

Sa i përket ngjyrës së tij (lëkurës, fytyrës), ishte e shndritshme, nuk ishte as zeshkan e as i veçuar në të bardhë. Shndritshmëria e tij ishte e bardhë, e pastër, në të cilën nuk kishte as verdhësi e as të kuqërremtë, e as ngjyrë tjetër.

Axha i tij, Ebu Talib, e përshkruante në vargje:

“Ashtu një fytyrë e bardhë që, për nder të asaj fytyre të bardhë kërkohet shiu nga retë. Ashtu një zemërmirë që, ushqen jetimët, mbrojtës i të vejave dhe të varfërve, dhe të gjithë e dinë këtë.”

Disa kanë thënë që fytyra e tij ishte përzierje kuq me bardhë. Dikush e përshkruante se si në fytyrën e tij kishte pjesë të kuqe. Por thuhej se e kuqja ishte e dukshme vetëm në ato pjesë të trupit të cilat kishin pasur kontakt me diellin dhe erën, siç ishin fytyra dhe qafa. Pjesët e tjera të trupit, të cilat mbuloheshin nën rroba, e kishin një bardhësi të pastër.

Djersa e tij shndriste si një margaritar, me aromë të mirë si miski. Kishte flokë të bukura, nuk i kishte as të drejta e as kaçurela. Kur i krihte dukej si valëzim i shkretëtirës. Thuhej se si flokët i arrinin gjer në supe, edhepse disa thonë deri te llapa e veshit. Ndoshta i mbështjellte të tillat, kështu që të dy veshët vinin në pah në mes të kaçurrelave,

e ndoshta i lëshonte mbi veshë, kështuqë zylyfët i dukeshin më të shëndritshëm. Në flokë dhe mjekër kishte shtatëmbëdhjetë qime të bardha, jo më shumë.

Kishte një fytyrë të bukur dhe me plot shkëlqim. Askush nuk e përshkruante, e të mos e krahasonte me hënën e plotë. Për shkak të pastërtisë së lëkurës së tij, si gëzimi si hidhërimi mund të shiheshin në fytyrën e tij.

Thuhet se ishte ashtu siç e përshkruajti shoku i tij Ebu Bekr as-Siddik, r.a., kur tha:

“Mustafaja, ishte një i besueshëm që thërriste njerëzit në lumturi. Si hëna e plotë që errësirën ndriçon.”

Kishte një ballë të hapur. Vetullat i kishte të gjata, të holla dhe të plota. Mesi i të dy vetullave ishte i hapur dhe shkëlqente si argjend. Kishte sy të bukur, të mëdhenjë dhe të zi. Në sytë e tij shihej edhe e kuqërremta. Kishte qerpikë të gjatë, dendësia e të cilave thujase i’ a mbulonin pamjen. Hundën e kishte të drejtë. Dhëmbët i kishte të ndarë. Kur buzëqeshte, dhëmbët shkëlqenin si inxhi. Në mes të robëve të Allahut, kishte buzët më të

bukura dhe gojën më të pastër. Faqet i kishte të buta dhe nuk ishin të varura. Nuk e kishte fytyrën e gjatë.

Mjekrën e lëshonte, derisa mustaqet i shkurtonte. Kishte qafën më të mirë nga robët e Allahut, as të gjatë e as të shkurtër. Ajo pjesë e qafës që kishte kontakt me diellin dhe erën shkëlqente si një gotë ari gdhendur mbi argjend.

Pjesët e tjera të trupit, të cilat mbuloheshin nën rroba, e kishin një bardhësi të pastër. Kishte gjoks të gjerë. Mishi nuk ishte i varur. Ishte i drejtë si pasqyrë, sikur hëna në bardhësinë e saj. Në mesin e gjoksit deri tek kërthiza, shtrihej si një linjë vija e qimeve. Qime të tjera në gjoks dhe bark nuk kishte. Kishte shpatulla të gjera dhe kishte eshtëra të fortë, do të thotë, eshtërat e krahërorit, bërrylave dhe kukave. Kishte shpinë të gjerë.

Në mes të supit ndodhej vula e *Nubuvetit* (pejgamberllëkut), pak më lartë se supi i djathtë. Kjo ishte një shenjë e zezë e shtrirë me një nuansë të verdhë. Rreth saj kishte qime, sikur të ishin jele e kalit.

Krahët ishin mjaft të mëdhenjë. Kyçi i dorës dhe duart ishin të gjera. Gishtat ishin mjaft të gjatë dhe me shkëlqim, ishte si argjend. Shuplaka e dorës ishte më e butë se gishti dhe aromatik. Ai që ia shtrëngonte dorën (*musafaha*) deri në mbrëmje në dorë e ndjente aromën. Cilit fëmijë i vënte dorën në kokë dhe e përkëdhelte, deri në mbrëmje koka e atij fëmije me aromë të mirë veçohej nga fëmijët e tjerë.

Pulpat e këmbëve i kishte të mëdha. Sa i përket ecjes së tij, dukej sikurse po zbriste nga shkëmbi, zbriste ngadalë sikur nga shpati. Hapat i kishte të matur. Ecte ngadalë, me shkathësi, ngadalë në kuptimin që hapat e tij ishin kompakt (njëri pranë tjetrit).

Thoshte:

“Unë jam nga njerëzit më të ngjashëm me Ademin Alejhisselam, derisa Ibrahim i Alejhisselam është më i ngjashmi me mua, edhe nga pamja edhe nga ahlaku.”

Poashtu thoshte:

“Unë tek Rabbi im kam dhjetë emra. Unë jam Muhammedi. Unë jam Ahmedi. Unë jam Mâhi - Allahu Teala me mua do të shkatërrojë kufrin. Unë jam Akib - pas meje nuk ka Pejgamber. Unë jam Hashir - pas meje Allahu Teala do t’i ringjallë (mbledh) pas vdekjes robërit e Tij. Unë jam Resul’i rahmet (i dërguari i mëshirës). Unë jam Resul’i tevbese (I dërguar i pendimit). Unë jame Resul’i Melahim. Unë jam Mukaffi. Unë jam Kusem pra i pjekur, dhe jam njeriu që i ka mbledhur të gjitha mirësitë.”⁶³

MUXHZIZET DHE SHENJAT QË E DËSHMOJNË VËRTETËSINË E RESULTALLAHUT S.A.V.S.

Dije se: ai që kupton Muhammedin s.a.v.s., punët në lidhje me ahlakun e tij, gjendjet dhe sjelljet, adetin dhe karakterin, ballafaqimin me njerëz të ndryshëm dhe miqësimi me bashkim, udhëheqjen dhe rregullimin e tij, udhëheqjen e tyre drejtë

⁶³ Ebu’sh-Shejh nga Abdullah b. Ubejdi.

nënshtrimit, ndër të gjitha ato se çfarë thuhet nga përgjigjet e tij të mahnitshme në pyetje të ndërlikuara, vlerësimin e tij për të mirën dhe mirëqenien e njerëzve, i ditur, i kujdesshëm, i matur, parandalues; çdokush - dijetar, faki dhe i mençur që kupton shenja të bukura në shpjegimet e urdhërave të Sheriatit, janë mahnitur përgjatë tërë jetës së tyre të gjatë, dhe nëse mendon mirë - nuk do të ketë kurrë dyshime se këto nuk përfitohen me fuqinë e vullnetit të njeriut, me mashtrimet me të cilat njerëzit zakonisht merren, dhe nuk do të ketë kurrë dyshime se këto përfitohen vetëm me ndihmën e fuqisë hyjnore dhe qiellore. Gjithë këtë është e pamundur ta imagjinosh nga një gënjeshtar dhe mashtrues.

Aftësitë e tij dhe gjendja janë dëshmi shumë të forta mbi vërtetësinë e tij. Arab i pastër nga shkretëtira, kur do ta shihte do të thoshte:

“Vallahi, kjo fytyrë nuk mund të jetë gënjeshtër.”

Vetëm nga dukja e jashtme dëshmonte vërtetësinë e tij. E të mos flasim për atë që di ahlakut dhe sjelljet e tij. Zaten, edhe ne dëshiroam ta vëmë në dijeni duke përmendur një pjesë të ahlakut të tij dhe virtyteve të tij, së bashku me këtë vërtetësinë e Resulallahut s.a.v.s., dhe pozitën e tij të lartë tek Allahu Teala. Ngase, Allahu Teala tërë këto i'a dha, derisa ishte i paarsimuar, nuk studionte, nuk lexonte libra apo udhëtonte në kërkim të diturisë. Ka jetuar në mes të bjeshkëve dhe në mesin e beduinëve si jetim. Në qoftë se nuk do t'a arrinte ndihma e Allahut Teala ku do të mësonte ai këto vlera të larta, bukuritë e ahlakut dhe urdhërat, e të mos i përmendim njohuritë e tjera?

Të mos flasim për njohuritë mbi Allahun, Librave dhe melekëve të Tij, veçori të Pejgamberëve dhe gjithçka tjetër sa i përket besimit.

Nese nuk do t'i arrinte shpallja (*vahj*) nuk do t'i dinte këto gjëra dhe fuqia e njeriut nuk do të kishte mundësi të rezistonte kaq barrë të rëndë.

Po të mos kishte asnjë muxhize, madje vetëm këto, do të ishte e mjaftueshme për dëshminë e *nubuvvetit* (pejgamberllëkut)të tij.

Megjithëkëtë, Resulallahu s.a.v.s., ka muxhize aq që assesi nuk lë vend për dyshim. Të tregojmë disa nga muxhizet e tij të mirënjohura, të cilat gjinden në librat të besueshëm, duke mos hyrë në detaje.

Allahu Teala përmes tij e ka prishur rregullin e zakonshëm të gjërave disa herë.

Kur Kurejshët i kërkuan një shenjë, Hëna u nda në dysh.⁶⁴

Gjatë ngjarjes së Hendekut në shtëpinë e Xhabirit dhe Ebu Talhes ka ushqyer me pak gjellë shumë njerëz.⁶⁵

Njëherë ushqeu tetëdhjetë persona me vetëm katër duar plot elb dhe një edh jo më të vjetër se një vjeçar.⁶⁶

Njëherë ushqeu më shumë se tetëdhjetë persona me një copë bukë elbi që Enesi e mbante në dorë.⁶⁷

⁶⁴ Buhariu dhe Muslimi nga Ibn Mesudi, Ibn Abbasi dhe Enesi, r.a.

⁶⁵ Buhariu dhe Musliminga Enesi, r.a.

⁶⁶ Bejheki nga Xhabiri r.a., edhe Buhariu, por nuk përmend numrin e personave të cilët atëherë ishin duke ngrënë.

E njëherë tjetër e ushqe u shtrinë me pak hurme të cilat i solli e bija e Bishirit.⁶⁸

Në luftë të Tebukut, kur ushtria kërkoi ujë nga Resulallahu s.a.v.s., ky pyeti:

“A nuk ka hiç ujë?” Kishte pak ujë në një *matara*, atë ia sollën, e mori në dorë, dhe në mes të gishtërinjëve të tij të bereqetshëm filloi të rridhte uji nga i cili e piu e tërë ushtria e etur, morën abdes dhe mbushën enët e ujit.⁶⁹

Poashtu Resulallahu a.s., duke derdhur pak ujë me dorë në burimet e Hudejbijje-s dhe Tebuk-ut të cilat ishin tharë, burimet u mbushën me ujë dhe nga këto burime pinte ujë ushtria, që numëronte mijëra luftëtarë.⁷⁰

⁶⁷ Muslimi nga Enesi r.a.

⁶⁸ Bejhaki në *‘Dalailu’-n--Nubuvvet’*.

⁶⁹ Buhariu dhe Muslimi nga Enesi, r.a., por vetëm me përmendjen e abdesit. Uji i cili qarkullon përmes gishtërinjëve përmendet në hadithin që e shënon Ebu Nuajm me një varg trasmetuesish të mirë. Poashtu, Taberani në *‘Kebirin’* e tij shënon hadithin nga Ibn Abbasi, r.a., në të cilin thuhet se si njëherë, derisa ishin në udhëtim, as’habët ankoreshin tek i Dërguari, s.a.v.s., për etje, në çka ai tha: *“Më sillni ujë!”* Ata i sollën një enë me ujë, ai e vendosi dorën e tij në të, kur uji filloi të rrjedhte mes gishtërinjëve të tij.

⁷⁰ Buhariu dhe Muslimi. Hadithi për burimin në Tebuku e shënon Muslimi nga Muadhi r.a., derisa hadithi për atë në Hudebije lidhet për Selemën ibnul-Ekvea. Këtë mrekulli të

Njëherë Resulallahu, s.a.v.s., i urdhëroi Omerit r.a., që të furnizojë katërqind kalorës me hurme e që kishte vetëm aq sa një deve që zë hapësirë kur gjunjëzohet, e megjithatë i furnizoi aq shumë sa edhe tepruan.⁷¹

Ushtrisë armike u hodhi pluhur syve, dhe ata nuk mund të shihnin.⁷² Në lidhje me këtë zbriti edhe ajeti:

“Dhe nuk hodhe ti, kur hodhe, por hodhi Allahu.” 8-Enfal: 17

Me dërgimin e Muhammedit a.s., Allahu Teala e anuloi *kehanet*-in.⁷³ Më përpara kishte kehanet.

Kur Resulallahu s.a.v.s. u ngjit në mimberin e sapo-ndërtuar, trangu i hurmes në të cilën mbështetej Resulallahu s.a.v.s. kur mbante hytben para se të ndërtohej mimberi, filloi të qajë, duke mos e duruar ndarjen.

Të Dërguarit a.s. e dëshmon edhe hadithi te Buhariu nga Bera.

⁷¹ Hadithin për këtë e shënon Ahmed ibn Hanbel nga en-Nu'mana ibn Mukarrinadhe Dukejna ibn Seida me një varg pasuesish të besueshëm

⁷² Këtë e vërteton hadithi i cili transmetohet nga Ibn Merdevejh në *Tefsirin* e tij nga Xhabiri dhe Ibn Abbasi, r.a.

⁷³ Kehanet:fjalë orakulli; profeci; profetizoj; parashikim fati.

Vajin e tij si zëri i devesë e dëgjuan të gjithë as'habët. Resulallahu s.a.v.s., zbriti nga mimberi, e përqafoi trungun, dhe heshti.⁷⁴

I bëri thirrje çifutëve në dëshirën për vdekje, duke i informuar se këtë gjë me siguri nuk do ta dëshirojnë, dhe në të vërtetë kështu ndodhi, dhe kështu dëshmoi mosdëshirën (heshtjen) e tyre. Ajeti i cili e shpjegon këtë ngjarje është duke u lexuar në tërë boten.⁷⁵

Resulallahu, a.s., jepte edhe lajme për gjërat e fshehura. Kështu e lajmëroi Osmanin r.a., se do t'i ndodhë një fatkeqësi dhe do të hyjë në Xhennet⁷⁶, e Amarin (ibn Jasir) se si do ta vras një grup rebelësh.⁷⁷

Për Hasanin (nipin e tij) thoshte se Allahu me këtë do të ndërmjetësojë për të pajtuar dy ushtri islame.⁷⁸

⁷⁴ Buhariu nga Xhabiri dhe Sehl ibn Sa'd, r.a.

⁷⁵ Buhari nga Ibn Abbasa, r.a.

⁷⁶ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Musa el-Esh'aris.

⁷⁷ Muslimi nga Ebu Katade dhe Ummu Seleme. Buhari nga Ebu Seid.

⁷⁸ Buhariu nga Ebu Bekreti.

Për një njeri që ka luftuar në rrugën e Allahut thoshte se i takonte banorëve të Xhehnemit. Më vonë u zbulua se se si ai njeri bëri vetëvrasje.⁷⁹

Të gjitha këto lajme janë nga shpallja hyjnore të cilat kurrë nuk mund të bëhen të njohura në bazë njohurive të mëparshme, duke shikuar në yje. Vetëm me shpalljen e Allahut Teala dhe me lajmërimin e Tij mund të njihen.

Resulallahu s.a.v.s., kur e lëshoi Mekën dhe u nis për në Medine, Suraka ibn Malik e pasoi dhe kur u afrua, këmbët e kalit të tij u zhytën në zall dhe u paraqit një tym. Suraka kërkoi ndihmë nga Resulallahu s.a.v.s., dhe Resulallahu s.a.v.s., bëri dua, e kali i tij u çlirua dhe paralajmëroi (Surakan) që do të vë në duar prangat e Kisras, perandorit të Persisë. Ashtu edhe ndodhi.⁸⁰

⁷⁹Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre dhe Sehl ibn Sa'd'it.

⁸⁰Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Bekri es-Siddik r.a.

Lajmëroi për vrasjen e gënjeshtarit Esvad-i Ansi, në natën kur ai u vra, edhe pse ai gjendej në Sana, qytet në Jemen. Madje edhe e emëroi atë që e ka vrarë.⁸¹

Doli para qindra Kurejshëve të cilët e prisnin për ta vrarë, hodhi para tyre një grusht dhé, e ata nuk e panë.⁸²

Njëherë, në prani të as'habëve të tij, një deve u ankua tek Resulallahu s.a.v.s., për pronarin.⁸³

Edhe njëherë në prani të as'habëve u tha se si njëri nga ta do të përfundojë në Xhehnem., dhe dhëmbi i tij është si kodra e Uhudit. Më të vërtetë njëri nga ta u vra si *myrted* (braktisës i fesë islame).

Prap, një grupi njerëzish u tha:

“Ai që do të vdes i fundit prej jush, do ta humb jetën në zjarr.” Ashtu edhe ndodhi. I fundit nga ta ra në zjarr, aty u dogj, dhe ashtu edhe vdiq.⁸⁴

⁸¹ Hadithet për këtë i shënojnë edhe Buhariu, dhe Muslimi nga Ebu Hurejre, r.a.

⁸² Ibn Merduje nga Ibn Abbasi, r.a.

⁸³ Ebu Davud nga Abdullah ibn Xhafer r.a.

⁸⁴ Taberani dhe Bejhekiu.

I thirri dy drunjë, ata i'u përgjigjën dhe u afruan, më pastaj i urdhëroi që të kthehen, dhe ata u kthyen në vend.⁸⁵

Resulallahu a.s., ishte me gjatësi mesatare, e kur ecte me njerëzit më të gjatë dukej më i gjatë se ata. Edhe kjo ishte nga muxhizet e tij.

Të krishterët i ftoi në mallkim dhe i njoftoi se nëse e pranojnë këtë ftesë, do të shkatërrohen. Ata besuan se po e thotë të vërtetën, dhe u tërhoqën.⁸⁶

Njëherë erdhën Amir ibn Tufejl me Erded ibn Kajs, e që ishin kalorës arab të njohur, ta vrasin Resulallahun s.a.v.s., por në mes tyre u krijua një ndarje, e Resulallahu s.a.v.s., shpëtoi dhe i mallkoi. Amiri vdiq nga sëmundja e gjëndrrave, e Erbedi nga vetëtima e cila e dogji.⁸⁷

⁸⁵ Ahmed ibn Hanbel nga Ali ibn Murre me pasues të besueshëm.

⁸⁶ Buhariu nga Ibn Abbasi, r.a.

⁸⁷ Taberani në *'Evsat'* nga Ibn Abassi, r.a.

Për Ubej ibn Halef, Resulallahu s.a.v.s., e njoftoi se ai do ta vriste, dhe kështu në ditën e Uhudit vetëm pak e gërvishi dhe Ubej ibn Halef vdiq.⁸⁸

Shoku i Resulallahut s.a.v.s., me të cilin së bashku kishin ngrënë mish të helmuar vdiq, por Resulallahu s.a.v.s, pas asaj jetoj edhe katër vite. Për më shumë, pjesa e helmuar e mishit (shpatulla) foli dhe i tregoi Resulallahut s.a.v.s., që është e helmuar.⁸⁹

Në ditën e Bedrit, Resulallahu a.s. i njoftoi njerëzit për vendin ku do të vdesin kurejshët e parë, dhe të gjithë e humbën jetën mu në atë vend të cilin e shenjoj Resulallahu s.a.v.s.⁹⁰

Sërish Resulallahu s.a.v.s., i lajmëroi se disa nga ummeti i tij do të luftojnë në det. Kështu edhe ndodhi.

Sipërfaqja e tokës u “palos” dhe i tregoi lindjen dhe perëndimin. Lajmëroi se si

⁸⁸ Bejhakui në *‘Dalailu’n- Nubuvve’* nga Seidi ibn Musejjebi.

⁸⁹ Muslimi nga Omer b.Hattabi r.a.

⁹⁰ Buhariu dhe Muslimi nga Ummu Haram.

pushteti i ummetit do të zgjerohej tek cepat të cilat ishin “palosur.”⁹¹ Ashtu edhe ndodhi. Pushteti u zgjerua nga lindja, toka e Turqëve, deri në perëndim, tek deti andaluzian dhe toka e Berberëve. Por nuk u zgjeruan drejt jugut dhe veriut, sikurse kishte lajmëruar Resulullahu, a.s..

Vajzën e tij Fatimen r.a., e lajmëroi se si ajo nga familja e tij (ehl-i bejti) e para do t’i bashkangjitej në atë botë. Ashtu edhe ndodhi.⁹² Nga ana tjetër, gratë e tij i njoftoi se ajo që e para do t’i bashkangjitet në ahiret do të jetë ajo që është më xhymertë. E ajo ishte Zejnep bint Xhahsh r.a., andaj e para edhe iu bashkangjiti në atë botë.⁹³

Kontrolloi me dorë gjirin e një deleje e cila nuk jepte qumësht, e më pas qumështi u shfaq. Ky ishte edhe sebeb përmes së cilit Ibn Mesudi r.a., e pranoi islamin.⁹⁴ Të njëjtën gjë e bëri edhe në tendë të Ummu Ma’bed-it.

⁹¹ Muslimi nga Aishe dhe Fatime, r.a.

⁹² Buhariu dhe Muslimi nga Ajshe dhe Fatime r.a.

⁹³ Hadithi për këtë transmetohet nga Muslimi nga Ajshe r.a.

⁹⁴ Ahmed ibn Hanbel nga Ibn Mesudi r.a.

Njërit nga as'habët e tij i ra syri, andaj Resulullahu, s.a.v.s., me dorën e tij i'a ktheu në vend, e më pas ky as'hab kishte sytë më të shëndoshë dhe më të bukur.⁹⁵

Në ditën e Hajberit, Resulallahu s.a.v.s., pështyu në syrin e hazreti Ailut r.a., i cili ishte i sëmurë, dhe në atë moment syri i tij u shërua dhe Resulallahu, a.s., e dërgoi me flamur në kështjellën e Hajberit.⁹⁶

As'habët kanë dëgjuar lavdërimin që e bënte ushqimi që gjendej para Resulallaht s.a.v.s.⁹⁷

Njëri nga as'habët ishte i lënduar në këmbë, andaj Resulallahu a.s., e preku me dorën e tij, dhe në atë moment këmba u shërua.⁹⁸

⁹⁵ Hadithin për këtë e transmetojnë Ebu Nuajm dhe Bejhakiu nga Katade ibn Nu'mani i cili ishte ai që i ra syri. Tek Bejhakiu thuhet se kjo ndodhi gjatë Betejës së Bedrit, derisa Ebu Nuajm thotë se kjo ndodhi në Betejën e Uhudit

⁹⁶ Buhariu dhe Muslimi nga hazreti Alia r.a., dhe Sehla bn Sa'da r.a.

⁹⁷ Buhariu nga Ibn Mesud r.a.

⁹⁸ Buhariu

Me një rast filluan që të mbarojnë ushqimet në ushtri në të cilën ishte edhe Resulallahu s.a.v.s.. Ai urdhëroi që të mblidhet gjithçka që kishte mbetur. U mbledh shumë pak, Resulallahu s.a.v.s., e tha duanë e bereqetit, e më pastaj urdhëroi që të afrohen të hanë. Njerëzit merrnin ushqim, dhe nuk mbeti asnjë në mesin e ushtarëve që nuk u mbush nga ajo sasi e vogël.⁹⁹

Hikemi, djali i As b. Vail'it, filloi të ecte duke u tundur, që të tallej me mënyrën e ecjes së Resulallahut, a.s.. Resulallahu i tha:

“Ashtu bëhu.” Ky person tërë jetën ashtu edhe eci.¹⁰⁰

Resulallahu, a.s., dëshironte që të merrte për grua një vajzë dhe babai i saj, duke kërkuar falje dhe duke tentuar të nxirrej nga propozimi i ofruar, tha se vajza e tij e ka lebrën, e që nuk e kishte. Resulallahu s.a.v.s., i'a ktheu:

“Le të jetë e tillë!” Dhe ajo me të vërtetë u bë me lebër.¹⁰¹ Fjala është për Ummu Shebib ibnul-Bersa.

⁹⁹ Buhariu dhe Muslimi nga Seleme ibnul-Ekvea

¹⁰⁰ Bejhaki në **‘Delailu’** nga Hinda ibn Hatixhe, edhe nga Hakimi në **‘Mustedrek’** nga Abdurrahman ibn Ebu Bekri.

Muxhize të Resulallahut s.a.v.s., ka edhe më shumë. Jemi kufizuar në ato të mirënjohura.

Ai i cili dyshon në rrënimin e rregullit të gjërave, duke menduar se këto ngjarje nuk janë transmetuar si *mutevātir* (lajm i besueshëm), por që *mutevātir* është vetëm Kur’ani, është i njëjtë sikur ai që shpreh dyshimin në trimërinë e hazreti Alisë r.a., dhe në mirësinë e Hatim-it, e kur dihet se ngjarjet individuale të lidhura me ta nuk janë *mutevātir*. Por, përmbledhjet e këtyre ngjarjeve kërkojnë njohuri të domosdoshme.

Më pastaj, në pasimin e Kur’anit nuk ka asnjë mëdyshje, e i cili është një mrekulli, që ndodhet në mesin e njerëzve. Asnjë pejgamber nuk e ka pasur mrekullinë e përhershme përveç Muhammedit - Resulallahu s.a.v.s., me të ka sfiduar gjuhëtarët dhe arabëfolësit, e në atë kohë gadishulli Arab ishte përplot me ta dhe me mijëra sosh.

¹⁰¹ Hadithi për këtë transmetohet nga Ibnul-Xhevzi në ‘*Telkih*’, duke thënë se ajo grua quhej Xhemra bintul-Hars ibn Avf el-Muzni.

Të folurit ishte zanati i tyre. Me të kanë garuar mes njëri-tjetrit dhe u ngritën. Resulallahu s.a.v.s., i ftoi që të vinin më diçka të ngjashme si Kur'ani, apo me dhjetë sure të ngjashme si të Kur'anit, apo me të paktën një sure, nëse kanë dyshim në të. Dhe u tha:

“Thuaj: ‘Sikur të tuboheshin të gjithë njerëzit dhe xhindet për të hartuar një Kuran të tillë, ata nuk do të mund të hartonin një të ngjashëm me të, madje, edhe sikur ta ndihmonin njëri-tjetrin’.” 17-Isra: 88

Zaten këtë u'a tha që ta bëj qartë pafuqinë e tyre dhe për t'i heshtur.

Zaten edhe ata e humbën shpresën, e kuptuan pafuqinë, e ndërruan mendjen dhe duke kapur shpatën vendosën të kundërshtojnë Kur'anin. E gjuajtën edhe vehten e tyre në vdekje, e humbën pasurinë, dhe gratë e fëmijët e tyre i dërguan në robëri.

Nuk mundën që ta kundërshtojnë. Nuk mundën që ta shkurtojnë bukurinë dhe madhështinë e Kur'anit . Kur'ani u zgjerua në tërë botën, lindje dhe perëndim, nga gjenerata në gjeneratë, nga shekulli në

shekull. Deri më tani kanë kaluar gati pesëqind vite (koha e Gazalit), dhe askush nuk ishte në gjendje që ta kundërshtonte.

Sa injorancë është dyshimi ende në vërtetësinë e Resulallahut s.a.v.s., duke ditur dhe dëgjuar gjendjen dhe sjelljet të tij, fjalimin, veprimin, ahlakun, muxhizet, vazhdimësinë e sheriatit deri në ditët e sotme, zgjerimin në sipërfaqen e tokës, duke qenë ai - Resulallahu s.a.v.s. – jetim, si i nënshtrohen Islamit mbretërit e kohës së tij, e edhe pas tij, e prapë të shfaqet dyshum mbi vërtetësinë e tij.

E sa shumë ndihmë hyjnore ka ai i cili beson fuqishëm në të, në vërtetësinë e tij, dhe e pason atë në gjithçka që lidhet me të!

E lusim Allahun e Madhëruar që të na dhurojë suksese në pasimin e tij në ahlakun, veprat, gjendjet dhe fjalët.

